

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5406
E mërkurë, 21 shkurt 2018
çmimi 0.40 €

E enjtja, vendimtare për demarkacionin



Seanca e jashtëzakonshme për votimin e demarkacionit pritet të mbahet nesër (e enjte) në orën 11:00. Kjo është kërkesa që i ka drejtuar kryeministri Ramush Haradinaj kryesisë së Kuvendit të Kosovës ■ FAQE 07

AVOKATI ANGLEZ RICHARD HARVEY KA DHËNË NJË DEKLARATË PËR GAZETËN "EPOKA E RE" RRETH FORMIMIT TË GJYKATËS SPECIALE ■ FAQE 3

Kosova për një kohë të gjatë u trajtua padrejtësisht nga ndërkombëtarët

Avokati i njohur Richard Harvey ka bërë me dije se Gjykata Speciale është një padrejtësi që po i bëhet popullit të Kosovës. Në këtë deklaratë ekskluzive dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se për një kohë të gjatë Kosova është trajtuar padrejtësisht nga komu-

niteti ndërkombëtar në shumë aspekte. Avokati Harvey, i cili në Gjykatën e Hagës ka mbrojtur ish-ushtarët e UÇK-së, Lahi Brahimaj dhe të ndjerin Haradin Bala, ka vlerësuar se drejtësia rrallë shërbehet duke ngritur gjykata për të hetuar vetëm një palë në një konflikt



FLET PËR "EPOKËN E RE", SALI BISLIMI ■ FAQE 4-5

Duhet konsensus politik për temat që e presin Kosovën

Drejtori i organizatës joqeveritare "Zëri Perëndimor i Kosovës", Sali Bislimi, ka thënë se viti 2018 është sfidues për Kosovën, pasi padrejtësisht ballafaqohet me Gjykatën Speciale, çështjen e vizave dhe krijimin e asociacionit të komunave serbe. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Bislimi ka thënë se të gjitha këto tema kërkojnë konsensus politik. Ai ka thënë se ratifikimi i demarkacionit me Malin e Zi duhet ta sjellë liberalizimin e vizave për Kosovën. Bislimi ka theksuar se Kosovës duhen t'i hapen dyert për integrim në BE, në NATO dhe në UNESCO

Arifi para deputetëve kërkon gjithëpërfshirje në dialogun me Serbinë



RENOVA
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Çarëz-Ferizaj
PUTZ
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GRUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel & Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

DEMARKACIONI DO TË KALOJË, PO PASTAJ KË DO TA MBËRTHEJË LEMZA! F.12



Behxhet Sh. SHALA-BAJGORA

SHQIPTARËT DUHET TË FRIKËSOHEN PËR MUNGESËN E SHTETEVE TË SË DREJTËS F.06



Jakup KRASNIQI

MBI 1 500 PERSONA PËSOJNË SULM NË TRU ÇDO VIT NË KOSOVË F.6

EKONOMI

HARADINAJ: KY ËSHTË VIT I TREPÇËS F.9

HAMZA U PREMTON PËRFAQËSUESVE MË TË MËDHENJ TË BIZNESEVE REFORMA FISKALE F.8

KULTURË

NJË STUDIM NDRYSHE PËR NOLIN F.15



Prof. dr. Sabile KEÇMEZI-BASHA

SPORT

MUND TA BEFASOJMË POLONINË F.18

Arifi para deputetëve kërkon gjithëpërfshirje në dialogun me Serbinë

Shefi i delegacionit të Kosovës për bisedimet me Serbinë, Avni Arifi, duke raportuar para deputetëve, ftoi përfaqësuesit e të gjitha subjekteve politike të përfaqësuar në Kuvend, që t'i bashkohen delegacionit të bisedimeve, duke vlerësuar se një gjithëpërfshirje më e madhe do të ishte shumë pozitive dhe do t'i kontribuonte një dialogu cilësor me më shumë transparencë

PRISHTINË, 20 SHKURT - Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, ka mbajtur të martën mbledhjen e radhës, në të cilën ka raportuar shefi i delegacionit të Kosovës për bisedimet me Serbinë, Avni Arifi.

Kryetarja e këtij komisioni, Vjosa Osmani, ka vënë në dukje rëndësinë e takimeve të tilla, me qëllim të transparencës sa më të madhe rreth zhvillimeve që kanë të bëjnë me dialogun. Ajo ka vlerësuar se takimet e tilla duhet të realizohen para çdo takimi të delegacionit tonë me palën serbe, në mënyrë që komisioni të

jetë paraprakisht i informuar me temat që do të diskutohen në Bruksel.

Duke folur për platformën e bisedimeve që do të vijojë në Bruksel ndërmjet delegacionit tonë dhe atij serb, shefi i delegacionit kosovar, Arifi, ka bërë me dije se në takimin e radhës (i cili pritet të mbahet më 26 shkurt) nuk do të bisedohet për marrëveshje të reja. Me këtë rast, ai ka theksuar se në këtë takim do të bisedohet për mënyrën e implementimit të marrëveshjeve të arritura deri më tani dhe për këtë ftoi përfaqësuesit e të gjitha subjekteve politike të përfaqë-

suara në Kuvend, që t'i bashkohen delegacionit të bisedimeve. Ai ka vlerësuar se një gjithëpërfshirje më e madhe do të ishte shumë pozitive dhe do t'i kontribuonte një dialogu cilësor me më shumë transparencë. Duke iu përgjigjur pyetjeve dhe shqetësimeve që ngritën anëtarët e komisionit, Arifi me këtë rast i siguroi ata se marrëveshjet e arritura janë në harmoni të plotë me ligjet dhe Kushtetutën e vendit. Ai, po ashtu, ka sqaruar se dialogu teknik i paraprind marrëveshjes përfundimtare, e cila ka për qëllim njohjen reciproke ndërmjet të dy vendeve.



Meta: Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, vija e kuqe për marrëveshjen detare

TIRANË, 20 SHKURT - Pasi publikoi përgjigjen për kërkesën e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, doli në një deklaratë për mediet. Ai u shpreh se publikimi i përgjigjes për kërkesën e MEPJ është bërë jashtë dëshirës së tij, por për të qenë transparent. Presidenti tha se "nuk mund të firmosë një letër të bardhë me disa probleme që duhen saktësuar". Meta tha në deklaratë se sjellja e presidentit për këtë çështje do të jetë e bazuar në Kushtetutë dhe në vendimin e Gjykatës Kushtetuese. "Duhet ta theksojmë mbështetjen dhe angazhimin tim për një zgjidhje të drejtë dhe përfundimtare për këtë çështje. Duhet të ketë një angazhim të plotë nga të gjithë. Me këtë rast, dua të nënvizoj se sjellja dhe kontributi i presidentit ndaj kësaj çështje do të jetë i bazuar vetëm në Kushtetutën e Shqipërisë dhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Të respektohet vendimi i Gjykatës Kushtetuese të prillit 2010 është vija e kuqe", u shpreh Meta. "Qëndrimi i opozitës ose përfaqësuesit të saj ka qenë që kjo çështje duhet të zgjidhet në

gjykatë ndërkombëtare me mirëkuptim mes palëve. Sigurisht se është një mundësi. Qeveria ka synuar dhe synon që kjo çështje të zgjidhet përsëri përmes negociatave. Duke respektuar qëndrimin e opozitës, ka të drejtën e saj, njëkohësisht respektoj qëndrimin e Qeverisë për t'i dhënë një zgjidhje përfundimtare kësaj çështje përmes negociatave të reja, por duhet të theksojmë se për këtë çështje ka një vendim të posaçëm të Gjykatës Kushtetuese, e cila është një vijë e kuqe për të gjithë, duke filluar nga presidenti i Republikës. Është detyrë e presidentit ta respektojë këtë vendim, sepse presidenti është betuar për mbrojtjen e Kushtetutës", tha Meta.



Rama: Presidenti i përbashkët, deklaratë e nxjerrë nga konteksti

TIRANË, 20 SHKURT - Propozimi i kryeministrit Edi Rama për një president të përbashkët për Shqipërinë dhe Kosovën, bërë në seancën solemne në 10-vjetorin e Pavarësisë së Kosovës, nuk ishte një propozim konkret i cili mund të marrë udhë në një të ardhme të afërt, por një imagjinatë. Kështu tha të martën kryeministri Edi Rama, duke sqaruar qëllimin e kësaj deklarate. "Së

pari nuk ishte një deklaratë, por ishte një imagjinatë. Ajo fjali vjen si rezultat i një sërë fjalish të mëparshme ku, ndër të tjera, thuhet se Serbia dhe Kosova do të kenë kryer me sukses dialogun e tyre të vështirë. Ishte një imagjinatë, që lidhet me një moment jubilar", tha ai.

Rama e cilëson si të tepruar reagimin që shkaktoi propozimi i tij në Tiranë, në Prishtinë, në rajon dhe

Bruksel, ndërsa thotë se ai është nxjerrë nga konteksti i fjalimit të tij. "Ky sport kombëtar dhe ndërkombëtar, shpeshherë ku merret një fjali, nxirret nga konteksti pastaj, për fat të keq, dëmtohet ajo çka mendohet se po riparohet, i mbetet vetëm konsumit të ditës. Ndërkohë që fjala ime në Kuvendin e Kosovës ishte një fjalë e mirëmenduar dhe e ndjerë deri në fund", tha Rama.

Bushati: Negociatat me Greqinë duan qetësi

TIRANË, 20 SHKURT - Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, e drejtuar nga Ditmir Bushati, ka reaguar ndaj publikimit të letrës nga presidenti Ilir Meta, në të cilën thuhet se kërkesa për autorizim për negociata me Greqinë

nuk është e qartë.

MEPJ thotë se po shqyrton letrën e presidentit të Republikës, në përgjigje të kërkesës së dërguar prej saj, për lëshimin e autorizimit për fillimin e negociatave me palën greke

për delimitimin e hapësirave detare mes dy vendeve.

Në vijim thuhet se çështjeve të ngritura nga presidenti i Republikës, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme do t'u përgjigjet në rrugë institu-

cionale. Sikundër nënvizohet se ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme është i angazhuar për t'i vijuar bisedimet e konsultimet e nisura me presidentin e Republikës për të gjitha çështjet me interes për këtë proces.

"Procesi i nisur me Greqinë është kompleks, ndaj kërkon qetësi, maturi, institucionalizëm dhe jo projektimin e një anomaliteti që nuk ekziston", thuhet në fund të qëndrimit të MEPJ-së.

Avokati anglez Richard Harvey ka dhënë një deklaratë për gazetën "Epoka e re" rreth formimit të Gjykatës Speciale

Kosova për një kohë të gjatë u trajtua padrejtësisht nga ndërkombëtarët

Avokati i njohur Richard Harvey ka bërë me dije se Gjykata Speciale është një padrejtësi që po i bëhet popullit të Kosovës. Në këtë deklaratë ekskluzive dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se për një kohë të gjatë Kosova është trajtuar padrejtësisht nga komuniteti ndërkombëtar në shumë aspekte. Avokati Harvey, i cili në Gjykatën e Hagës ka mbrojtur ish-ushtarët e UÇK-së, Lahi Brahimaj dhe të ndjerin Haradin Bala, ka vlerësuar se drejtësia rrallë shërbehet duke ngritur gjykata për të hetuar vetëm një palë në një konflikt

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 20 SHKURT - Avokati i njohur anglez Richard Harvey e ka kritikuar bashkësinë ndërkombëtare për krijimin e Gjykatës Speciale për Kosovën. Avokati Harvey ka shprehur skepticizëm për rezultatin e kësaj gjykate. Në një deklaratë ekskluzive dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se Kosova prej pas luftës është trajtuar padrejtësisht nga komuniteti ndërkombëtar. "Besoj se populli i Kosovës për një kohë të gjatë është trajtuar padrejtësisht nga komuniteti ndërkombëtar në shumë aspekte", ka thënë Harvey.

Ai nuk beson se një gjykatë e tillë do të mund të vendosë drejtësi. Sipas avokatit, i cili në Gjykatën e Hagës ka mbrojtur ish-ushtarët e UÇK-së, Lahi Brahimaj dhe të ndjerin Haradin Bala, asnjëherë deri më tani nuk është vendosur drejtësi, duke e hetuar vetëm njërin palë në një konflikt. "Drejtësia rrallë shërbehet duke ngritur gjykata për të hetuar vetëm një palë në një konflikt", është shprehur Harvey për "Epokën e re".

Avokati i njohur anglez ka bërë me dije se do të jetë vështirë që pas kaq vitesh dhe pas disa het-

imesh ndërkombëtare që janë bërë deri më tani, të gjenden prova të reja për t'i vërtetuar krimet e pretenduar të luftës. Pritjet e avokatit Harvey janë që Gjykata Speciale nuk do të mund të bëjë asgjë më shumë se gjykatat e UNMIK-ut, Gjykata Ndërkombëtare e Hagës dhe gjykatat e EULEX-it. Madje ai është shprehur se do të befasohet shumë nëse Gjykata Speciale do të mund të siguronte dëshmi serioze në lidhje me ndonjë krim të rëndë që nga koha e luftës. "Pas kaq shumë vitesh dhe shumë hetimesh nga ICTY, UNMIK-u dhe EULEX-i, me të gjitha resurset në dispozicion të tyre, do të isha shumë i befasuar nëse do të mund të prodheshin dëshmi serioze dhe të besueshme që do të siguronin prova përtej dyshimit të arsyeshëm në lidhje me ndonjë krim të rëndë nga koha e luftës", është shprehur avokati Harvey. Sipas tij, në këtë kohë askush nuk mund ta justifikojë formimin e kësaj gjykate. "Më duket shumë e vështirë të shoh ndonjë justifikim për ngritjen e një gjykate tjetër në këtë kohë", ka deklaruar avokati anglez. Ai nuk ka dashur ta komentojë iniciativën e disa deputetëve të Kosovës për shfuqizimin e Ligjit për Gjykatën Speciale.



Me arsyetimin se nuk e nje mirë Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ai nuk ka dashur të flas nëse Kosova njëanshëm mund ta ndalë Gjykatën Speciale. "Unë nuk jam ekspert për Kushtetutën e Kosovës dhe nuk mund të spekuloj për ndonjë pasojë të mundshme nëse Kosova refuzon të bashkëpunojë me Tribunalin", ka thënë Harvey.

Më 22 dhjetor të vitit të kaluar organizatat e dala nga lufta e UÇK-së mblodhën mbi 10 mijë

nënshkrime. Ndërkaq pas kësaj 43 deputetë kishin nisur iniciativën për ta shfuqizuar Ligjin për Gjykatën Speciale, por pas dy përpjekjeve partnerët e koalicionit qeverisës nuk arritën të krijojnë kuorum në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit për ta proceduar më tutje këtë çështje. Kjo iniciativë, qysh në fillim, ishte kundërshtuar fuqishëm nga ambasadori amerikan në Kosovë dhe koleget e tij të vendeve perëndimore. Madje ata kishin paralajmëruar pasojë

për Kosovën dhe deputetët nëse do të vijë deri te shfuqizimi i Ligjit për Speciale. Kjo iniciativë ishte kundërshtuar edhe nga LDK-ja. Ndërsa presidenti Hashim Thaçi dhe kryeministri Ramush Haradinaj patën deklaruar se kjo çështje u takon deputetëve dhe ata do të respektojnë çfarëdo vendimi të Kuvendit.

I pari lider që e kishte kundërshtuar publikisht këtë iniciativë ishte kryeparlamentari, njëherësh kryetar i PDK-së, Kadri Veseli, i cili kishte thënë se Gjykatën Speciale më së paku në botë e ka merituar Kosova që t'i ndodhë, por ajo do të ndodhë. Në janar të këtij viti kryesia e Kuvendit të Kosovës ka vendosur që iniciativën për shfuqizimin e Ligjit për Speciale ta dërgojë për vendim në Qeveri. Dhe, tek më pas, liderët shtetërorë, duke filluar prej presidentit, kryeministrit dhe zyrtarëve më të lartë të koalicionit qeverisës, u deklaruan publikisht se Ligji për Gjykatën Speciale nuk do të shfuqizohet dhe se Kosova do të përballlet me këtë padrejtësi. Kuvendi i Kosovës më 3 gusht të vitit 2015 kishte bërë ndryshimet e nevojshme kushtetuese për këtë gjykatë dhe pati miratuar me procedurë të përsheptuar Ligjin për Gjykatën Speciale. Miratimi ishte bërë pa pjesëmarrjen e partive të opozitës, të cilat atë kohë i kishin bojkotuar punimet e Kuvendit. Kuvendi, po ashtu, kishte miratuar edhe Projektligjin për Mbrojtjen Juridike dhe Mbështetjen Financiare të Personave të Akuzuar Potencialë në Proceset Gjyqësore në Gjykatën Speciale. Mandati i Gjykatës Speciale për krime lufte përfshin periudhën kohore nga viti 1998 e deri në fund të vitit 2000.

Thaçi dekoron Kushnerin me Medaljen Presidenciale

PRISHTINË, 20 SHKURT - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka dekoruar ish-shefin e UNMIK-ut, Bernard Kushner, me Medaljen Presidenciale Jubilarë të dhjetëvjetorit të pavarësisë. Presidenti Thaçi ka treguar se gjatë takimit me Kushnerin kujtuan periudhën e pasluftës dhe të shtetndërtimit në Kosovë. "Me shumë sakrificë, ndërtaam institucionet mbi rrënojat e luftës, krijuam

parakushte për rimëkëmbje dhe menaxhuam situatën e sigurisë. Sot, 19 vjet më vonë, u pajtuam që shtetndërtimi ishte i suksesshëm, derisa të ardhmen duhet ta ndërtojmë mbi bazën e sukseseve të së kaluarës. Për këtë kontribut, mikun tim dhe të Kosovës, Bernard Kushner, e dekorova me Medaljen Presidenciale Jubilarë të dhjetëvjetorit të Pavarësisë", ka thënë Thaçi pas takimit.



Flet për "Epokën e re", Sali Bislimi

Duhet konsensus politik për temat që e



Drejtori i organizatës joqeveritare "Zëri Perëndimor i Kosovës", Sali Bislimi, ka thënë se viti 2018 është sfidues për Kosovën, pasi padrejtësisht ballafaqohet me Gjykatën Speciale, çështjen e vizave dhe krijimin e asociacionit të komunave serbe. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Bislimi ka thënë se të gjitha këto tema kërkojnë konsensus politik. Ai ka thënë se ratifikimi i demarkacionit me Malin e Zi duhet ta sjellë liberalizimin e vizave për Kosovën. Bislimi ka theksuar se Kosovës duhen t'i hapen dyert për integrim në BE, në NATO dhe në UNESCO

EPOKA E RE **Faton DERMAKU**

PRISHTINË, 20 SHKURT -

"Epoka e re": Z. Bislimi, së fundmi keni themeluar organizatën joqeveritare "Zëri Perëndimor i Kosovës". Cili është qëllimi i saj?

Bislimi: Themelimi i OJQ-së "Zëri Perëndimor i Kosovës" është bërë me qëllim të promovimit të vlerave dhe civilizimit perëndimor në Kosovë dhe nga Kosova në vendin ku jetoj, pra në Zvicër, e kudo në

Evropë. Kohët e fundit ka një lajthitje dhe hezitim të popullit shqiptar për vlerat europereëndimore për shkaqe të interesave meskine, por edhe në shërbim të grupeve radikale të cilat veprojnë në shoqërinë tonë. Vendet arabe dhe të botës së tretë, duke e shfrytëzuar varfërinë dhe gjendjen sociale në Kosovë, investojnë shumë duke importuar mentalitetin dhe kulturën arabe në Kosovë dhe hapësirat shqiptare. Madje kanë arritur edhe shpëlarjen e trurit dhe joshjen e individëve

dhe grupeve radikale e ekstremiste për t'iu bashkangjitur ISIS-it, terrorizmit radikal islamik, i cili është kanceri dhe e keqja e popujve të civilizuar në nivel global. Shqiptarët duhet ta luftojnë dhe ta çrrënjosin nga trojet e tyre këtë të keqe. OJQ "Zëri Perëndimor i Kosovës" është një dritë në tunelin e errësirës të këtyre grupeve antikombëtare në Kosovë.

"Epoka e re": Ju jetoni në Zvicër dhe shumë herë keni qenë pjesë e takimeve në kuadër të Partisë

Liberales të Kosovës (PLK) në Bruksel. Si i shihni proceset integruese të Kosovës?

Bislimi: Ç'është e vërteta, unë ka vite që, si shumë të tjerë, kam migruar në Zvicër, në këtë vend mik, ligjor dhe demokratik, i cili është një atdhe alternativ imi dhe i qindra e mijëra shqiptarëve. Ndonëse në migrim për asnjë moment nuk kam pushuar aktivitetet politike e kombëtare që nga themelimi i LDK-së e deri te kyçja ime e drejtpërdrejtë në strukturat e larta të Partisë Liberale të Kosovës, e cila që nga themelimi i vitit 1991, themeluar nga lideri politik i saj, z. Gjergj Dedaj, ka luajtur rol të rëndësishëm për afirmimin e çështjes së Kosovës në Evropë dhe botë. PLK-ja ishte subjekti i parë politik i Kosovës i anëtarësuar në strukturat politike të Evropës dhe botës.

Bashkë me liderin e saj, z. Dedaj, kam marrë pjesë në konferenca ndërkombëtare për Kosovën, kongrese, vizita në Parlamentin Evropian, Këshillin e Evropës e kudo për të bërë miq dhe aleatë për liri, para, gjatë dhe pas luftës. Do të vazhdoj, me tërë energjinë time, ta mbështes këtë vizion politik të PLK-së edhe në të ardhmen drejt proceseve integruese euroatlantike. Kosova duhet ta marrë me seriozitet çështjen e integritimit evropian. Në këtë proces nuk duhet të ketë ndarje, por bashkim të pozitës dhe të opozitës.

"Epoka e re": A besoni se me ratifikimin e demarkacionit do të ndodhë liberalizimi i vizave, sepse ka zëra që thonë se, pavarësisht prej ratifikimit të demarkacionit, nuk do të ketë

presin Kosovën

dhe opozitën, kur kemi parasysh se vendi ka shumë tema të rëndësishme me të cilat kërkohet unitet, si demarkacioni, asociacioni i komunave me shumicë serbe dhe Gjykata Speciale?

Bilimi: Qeverisja aktuale, si çdo qeveri e kaluar, ballafaqohet me sfida, probleme dhe kërkesa nga më të ndryshmet. Varfëria dhe papunësia e lartë e vënë pushtetin aktual në një vështirësi sfiduese. Pra, ka vend për kritika, ka dukuri nepotiste, korruptive dhe privatizim apo uzurpim të institucioneve shtetërore dhe ministrive të caktuara, duke i konsideruar si kompani private. Viti 2018 është një vit sfidues, sepse Kosova padrejtësisht ballafaqohet me Gjykatën Speciale, çështjen e vizave, krijimin e asociacionit të komunave serbe dhe me sfida të tjera të cilat kërkojnë konsensus politik, urtësi, debat dhe, pse jo, edhe referendum gjithëpopullor.

"Epoka e re": Po për diplomacinë e Kosovës, cili është opinioni juaj?

Bilimi: Diplomacia e Kosovës është akoma provincialiste, e papërvojë dhe partiake. Me diplomaci duhet të merren ata të cilët kanë bagazh në diplomaci, të shkolluarit për diplomaci dhe, pse jo, gjenerata e re e arsimuar në Kosovë apo edhe kudo në botë, në universitetet prestigjioze dhe me renome. Diplomacia është pasqyra dhe fytyra e Kosovës jashtë. Thellimi i partneritetit me ShBA-në, BE-në, NATO-n dhe miqtë tanë nuk bëhet me individ mediokër, sharlatanë, militantë partiakë, teze, dajë e halla dhe të papërvojë. Vetë fakti i demtimit të imazhit të Kosovës në botë tregon nivelin e diplomacisë së Kosovës.

liberalizim?

Bilimi: Tema e vizave është një sanksionim i padrejtë për qytetarët e Kosovës. Lëvizja e lirë e njerëzve, ideve, kapitalit, mallrave, tregtisë dhe koncepteve politike, është e drejtë fundamentale njerëzore dhe humane, e garantuar me konventa ndërkombëtare. Kosovarët pa të drejtë janë privuar dhe izoluar në getoizim. Pa dyshim se ratifikimi i demarkacionit duhet të sjellë liberalizim të vizave për Kosovën. Ne jemi gjeografikisht, politikisht dhe historikisht pjesë e Evropës. Prandaj, Evropa duhet të na i hapë dyert për lëvizje të lirë dhe integrim në BE, NATO, UNESCO, OSBE, OKB dhe në të gjitha organizatat e tjera ndërkombëtare.

"Epoka e re": Çfarë mendimi keni për qeverisjen në vend

Kërkohet punë më intensive për procesin e integrimit

Përfaqësues të institucioneve të Kosovës dhe përfaqësues të Zyrës së Bashkimit Evropian kanë bërë thirrje për më shumë punë intensive rreth procesit të integrimit. "Procesi i zgjerimit bazohet në merita. Duhet të ketë përkushtim më të madh ndaj luftës së krimit dhe korrupsionit, si dhe duhet të ketë administratë më të pavarur. Këto janë kushte thelbësore", ka thënë Apostolova

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINE, 20 SHKURT - Ministria e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka marrë pjesë të martën në konferencën "Momenti i ri për zgjerimin në BE: Çfarë mund të përfitojë Kosova?", e organizuar nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS), në të cilën kanë marrë pjesë përfaqësues të Zyrës së Bashkimit Evropian, ambasadorë e ekspertë të integrimit evropian. Në fjalën e rastit ministria Hoxha ka theksuar perspektivën e padiskutueshme evropiane për Kosovën, duke ndërtuar institucionet, shtetin demokratik dhe me ekonomi të qëndrueshme. "Sfidë e parë ka qenë krijimi i institucioneve, kurse sfidë e vazhdueshme është reformimi dhe fuqizimi i tyre. Shpallja e pavarësisë ka sjellë një dinamikë të re dhe sigurisht sfida të tjera", ka thënë ministria Hoxha, duke

vënë theksin te Marrëveshja e Stabilizim Asociimit me BE-në. Ministria e sheh si mjaft pozitive dhe moment kthese për të ardhmen e të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor, në veçanti të Kosovës, Strategjinë e Zgjerimit të BE-së. "Reformat që kërkohen nga Kosova janë substanciale dhe prekin sektorët më të rëndësishëm. Konsideroj se një nga përfitimet është fakti se BE-ja bëri të qartë se në cilat fusha duhet fokusuar dhe cilët sektorë duhen reformuar e fuqizuar", është shprehur Hoxha. Në këtë drejtim ministria Hoxha ka theksuar se Kosova duhet të fokusohet për fuqizimin e sundimit të ligjit, sigurinë dhe migracionin, zhvillimin social dhe ekonomik, si dhe marrëdhëniet me shtetet fqinje. Ajo ka pohuar se të gjitha fushat në të cilat Strategjia e Komisionit Evropian kërkon fokus dhe përparim janë të domosdoshme për Kosovën. "Të gjitha detyrat që ne duhet

t'i kryejmë janë të përcaktuara në MSA dhe Agjendën Evropiane për Reforma dhe Programin për Reforma Ekonomike. Ne vetëm duhet t'i zbatojmë këto dhe sa më shpejt që këtë e bëjmë, aq më shpejt ecim përpara drejt anëtarësimit në BE", ka deklaruar ministria Hoxha, duke vënë në dukje se vetëm kështu u shërbejmë qytetarëve tanë duke u bërë pjesë e BE-së.

Ndërkaq përfaqësuesja e BE-së në Kosovë, Natalia Apostolova, ka thënë se Kosova duhet t'i plotësojë kushtet, pastaj të aplikojë për statusin e kandidatit në BE. "Procesi i zgjerimit bazohet në merita. Duhet të ketë përkushtim më të madh ndaj luftës së krimit dhe korrupsionit, si dhe duhet të ketë administratë më të pavarur. Këto janë kushte thelbësore", ka thënë Apostolova. Sipas saj, vendimi për anëtarësimin e Kosovës në BE duhet të merret pasi të sqarohet situata në terren.



Shqiptarët duhet të frikësohen për mungesën e shteteve të së drejtës



Shkruan:
Jakup KRASNIQI

I kemi njëqind e një mijë probleme, secili më i rëndë se tjetri, e nuk merremi seriozisht me asnjërin, ndërsa bie një deklaratë, e cila për t'u dëgjuar

nga shqiptarët është goxha joshëse për klikime, por që tani për tani nuk ka një përmbajtje serioze.

Edhe autori i saj e di mirë këtë, por që ia ka ënda të tregohet më intelektual se të tjerët. Dhe këtë nivel e mban dhe e plaslon shumë mirë. Duhet pasur lakmi, ç'është e vërteta për këtë prirje shoumeni.

Një gjë që duhet thënë në këto momente është se: Bashkimi jo vetëm i Kosovës me Shqipërinë, por edhe bashkimi i të gjitha trojeve shqiptare në Ballkan po të ndodhte, nuk do ta rrezikonte paqen as në rajon e as në

Evropë, përkundrazi, vetëm atëherë në Ballkan do të krijoheshin kushte për një paqe të qëndrueshme. Se vetëm atëherë do të krijoheshin partneritetet në mes të popujve të Ballkanit; se vetëm atëherë do të krijoheshin një ambient për jetësimin e vlerave evropiane në Ballkan... Mbase vetëm atëherë do të krijoheshin mundësitë për një Ballkan me siguri të plotë e pa barriera tregtare e doganore.

E them këtë për ata që po mendojnë se bashkimi i Kosovës me Shqipërinë gjoja se krijon Shqipërinë e Madhe. Edhe po të

ndodhte bashkimi i Kosovës me Shqipërinë, nuk do të krijoheshin as Shqipëria e Madhe, as Shqipëria e Vogël, por do të krijoheshin një Shqipëri me aq e aq troje shqiptare të lëna padrejtësisht jashtë saj. Por, as për njërin e as për tjetrin rast nuk ka ndonjë angazhim politik serioz, kështu që kot frikësohen ata që nuk u bënë trima dot! Debatet i zhvilluar pas fjalës solemne, po tregojnë se shqiptarët, edhe po të ishin bashkë, kanë probleme të brendshme aq të mëdha sa nuk rrezikojnë asnjë tjetër jashtë tyre.

Secili nga politikanët e ka të

drejtën të jetë parashikues, por politikanëve nuk u ka hije të frikësohen nga deklaratat politike, për të cilat duhet të punojnë pa zhurmë. Ndërsa nëse dikush u frikësohet hajnave, konsideroj se është më mirë një hajn i vetëm se shumë të tillë, sepse hajnat e shumtë po frikësohen nga humbja e pashallëqeve të hajnive të rezervuara për "pashallëkun" e mjerë të tyre.

Të gjithë duhet të frikësohuni për mungesat e shteteve të së drejtës. Frika do të duhej të vijë nga vendimet e qeveritarëve sesa nga fjalët e bukura të tyre.

Mbi 1 500 persona pësojnë sulm në tru çdo vit në Kosovë



Në Klinikën e Neurologjisë gjatë vitit 2017 kanë qenë të hospitalizuar mbi 1 500 raste të pacientëve me sulm në tru. Neurologu në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, Nexhmedin Shala, ka thënë se mënyra se si ekzaminohet dhe trajtohet kjo sëmundje nuk i përmbush as kriteret minimale

Prishtinë, 20 shkurt - Sëmundja nga aksidenti vaskular trunor ose siç njihet në gjuhën popullore si "pika në tru", është sëmundja e tretë për nga vdekshmëria si dhe e gjashta për nga barra që e bartim familja dhe shteti.

Në Klinikën e Neurologjisë gjatë vitit 2017 kanë qenë të hospitalizuar mbi 1 500 raste të pacientëve me këtë sëmundje. Vdekshmëria arrin deri në 40 për qind të rasteve të prekura

nga ky lloj sulmi. Këto të dhëna i ka dhënë për "Radion Evropa e Lirë", Nexhmedin Shala, neurolog në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës. "Në Klinikën e Neurologjisë janë rreth 1 500 pacientë që shtrihen gjatë një viti nga kjo sëmundje. Mënyra se si ekzaminohet dhe trajtohet kjo sëmundje nuk i përmbush as kriteret minimale. Nëse analizojmë kushtet e punës në Klinikë, mund të them se ato nuk janë më të mirat, e ky

është ai segmenti që shteti duhet ta shtrijë dorën për përmirësimin e kushteve", ka thënë Shala. Ai ka përmendur edhe mungesën e infermierëve në Klinikën e Neurologjisë, e që është një ndër problemet që ata përballen.

Drejtori i Departamentit për Informim në Ministrinë e Shëndetësisë, Faik Hoti, ka pohuar se janë të vetëdijshëm për sfidat që i ka QKUK-ja, por që potencon faktin se këtë vit

kanë filluar me zgjerim të ofrimit të shërbimeve shëndetësore. "Për Ministrinë e Shëndetësisë është e rëndësishme të ketë kushte për punë dhe ato të jenë optimale. Por, për raste që nuk mund të ketë zgjidhje brenda QKUK-së, ministria e ka programin për trajtimin jashtë (shtetit) për ofrim të shërbimeve, por që i gjithë potenciali është i orientuar që spektri i shërbimeve të zgjerohet dhe tashmë kemi filluar t'i zgjerojmë këto shërbime", ka thënë Hoti.

Ai ka shtuar se tashmë kanë marrë vendim që mbi 100 infermierë dhe teknikë të pranohen vetëm në Qendrën Klinike Universitare, ku të njëjtit do të

shpërndahen nëpër klinika, varësisht nga nevoja që kanë ato. "Gjatë këtyre ditëve, sipas informatave që kam, ka përfunduar shpallja e rezultateve për rekrutimin e më se 100 infermierëve dhe teknikëve e të cilët do të punësohen nëpër klinika të ndryshme të QKUK-së, me forcim të kapaciteteve dhe krijes së vëllimit dhe cilësisë së shërbimeve", ka deklaruar Hoti.

Shoqata e Neurologëve të Kosovës dhe Klinika e Neurologjisë e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës shpreh nevojën e vetëdijesimit të popullatës, por edhe të personelit mjekësor për masat parandaluese të kësaj sëmundjeje.

Seanca për ratifikimin e demarkacionit mbahet të enjten

E enjtja, vendimtare për demarkacionin

Seanca e jashtëzakonshme për votimin e demarkacionit pritet të mbahet nesër (e enjte) në orën 11:00. Kjo është kërkesa që i ka drejtuar kryeministri Ramush Haradinaj kryesisë së Kuvendit të Kosovës. Ai ka shprehur optimizëm që projektligji i demarkacionit do të përkrahët nga të gjithë deputetët e Kuvendit sepse, sipas Haradinajt, ratifikimi i kësaj marrëveshjeje është vendim i rëndësishëm për qytetarët e Kosovës. Edhe ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë, Greg Delawie, ka shprehur optimizëm se të gjithë deputetët nga të gjitha partitë do të votojnë pro demarkacionit. Ai ka thënë se ratifikimi i marrëveshjes për demarkacionin me Malin e Zi do t'u mundësonte qytetarëve të Kosovës të lëvizin lirshëm nëpër Evropë

EPOKA
ERE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 20 SHKURT - Qeveria e Republikës së Kosovës të martën ka miratuar plotësimin e projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes për shënjimin e vijës kufitare në mes të Kosovës dhe Malit të Zi. Më pas kabineti qeveritar ka proceduar në Kuvend për miratim të projektligjit, të cilit i është bashkëngjitur edhe deklarata e nënshkruar nga presidentët Thaçi dhe Vujanoviq, për rishikimin dhe korrigjimin e gjendjes në drejtim

të Çakorrit dhe Kullës.

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, në një konferencë për medie ka bërë me dije se ka kërkuar nga Kryesia e Kuvendit që seanca e jashtëzakonshme për votimin e demarkacionit të mbahet nesër (e enjte) në orën 11:00. "Plotësimi i projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes për kufirin shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi tashmë është kryer. Ky projektligj u aprovua dhe u procedua për Kuvendin e Kosovës. Projektligji i ri përmban raportin e komisionit shtetëror të udhëhe-



Delawie: Shpresoj që të gjithë deputetët nga të gjitha partitë do të votojnë pro demarkacionit

Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë, Greg Delawie, ka thënë se ratifikimi i marrëveshjes për demarkacionin me Malin e Zi do t'u mundësonte qytetarëve të Kosovës të lëvizin lirshëm nëpër Evropë. Ai ka

shprehur optimizëm se të gjithë mund të pajtohen për këtë dhe të gjithë deputetët nga të gjitha partitë do të votojnë për. "Kalimi i marrëveshjes për demarkacionin me Malin e Zi është esencial për sigurimin e mundësisë që të gjithë qyte-

tarët e Kosovës nga të gjitha komunitetet të mund të lëvizin lirshëm nëpër Evropë. Të gjithë mund të pajtohen për këtë dhe shpresoj që të gjithë deputetët nga të gjitha partitë do të votojnë për", ka shkruar Delawie në llogarinë e vet në "Twitter".

Sot mbahet mbledhja e kryesisë së Kuvendit për demarkacionin

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka bërë me dije se sot (e mërkurë) në orën 16:00 do të mbahet mbledhja e kryesisë së Kuvendit në të cilën do të vendoset për seancën e demarkacionit. "Kuvendi i Kosovës ka pranuar nga Qeveria e Kosovës Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes për kufirin shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Malit të Zi. E kam ftuar mbledhjen e kryesisë së Kuvendit, për të mërkurën në orën 16:00, për ta proceduar më tutje këtë çështje. Ftoj të gjithë deputetët të mendojnë për interesin e qytetarëve dhe ta përkrahin këtë marrëveshje, e cila forcon sovranitetin e vendit dhe i hap rrugë liberalizimit të vizave për qytetarët tanë", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook".

qur nga Shpejtim Bulliqi dhe deklarata e përbashkët të nënshkruar nga presidentët Thaçi - Vujanoviq. Të gjitha tani janë në një dokument. Tashti Kuvendi duhet të veprojë. Menjëherë pas miratimit të projektligjit në Qeveri, i kam dërguar një shkresë Kryesisë së Kuvendit, me ç'rast kam kërkuar seancë të jashtëzakonshme për të enjten në orën 11:00 për projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes së kufirit shtetëror në mes të Kosovës dhe Malit të Zi", ka deklaruar Haradinaj.

Ai ka shprehur optimizëm që projektligji i demarkacionit do të përkrahët nga të gjithë deputetët

e Kuvendit të Kosovës. Sipas Haradinajt, ratifikimi i marrëveshjes së kufirit shtetëror në mes të Kosovës dhe Malit të Zi është vendim i rëndësishëm për qytetarët e Kosovës. "Deklarata e nënshkruar nga dy presidentët e ka dhënë mundësinë e rishikimit të dy sektorëve, për të cilët ka pasur të gjetura në të kaluarën, prandaj duhet korrigjuar. Duke u bazuar në gjendjen që kemi, raporti i komisionit të ri shtetëror dhe deklarata e dy presidentëve na ka krijuar terrenin për të ecur përpara. Sido që t'i quajmë, korrigjime teknike apo përmbajtësore, është lajm i mirë. Me rëndësi është që parashihet korrigjimi në

dy sektorët e caktuar. Shpresoj se të enjten do të jemi unikë dhe do ta kemi një përkrahje maksimale për këtë vendim kaq të rëndësishëm për qytetarët e Kosovës", është shprehur Haradinaj.

Ai ka thënë se Kosova nuk e ka obliguar Malin e Zi që ta miratojë deklarata e dy presidentëve meqë, sipas Haradinajt, kjo është çështje e autoriteteve malazeze. "Marrëveshja është nënshkruar nga presidenti i Malit të Zi dhe ne nuk i obligojmë ata të miratojnë këtë marrëveshje. Kjo marrëveshje e nënshkruar nga presidenti i Malit të Zi neve na mjafton për të ecur përpara", ka theksuar Haradinaj.

Ish-kryetari i Kuvendit të Austrisë: Jam i lumtur kur e shoh një Kosovë krejt tjetër



PRISHTINË, 20 SHKURT - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka pritur të martën në takim ish-kryetarin e Kuvendit të Austrisë në periudhën 2002-2006 dhe deputet nga viti 1983, Andreas Khol.

Presidenti Thaçi e ka falënderuar atë për rolin e rëndësishëm për ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës që nga vitet e '90-ta, si kritikues i ashpër

ndaj shkeljes së të drejtave të shqiptarëve të Kosovës si dhe ndaj mbylljes së universitetit, akademisë dhe shkollave shqiptare. "Austria ka qenë dhe mbetet ndër miqtë kryesorë të Kosovës. Ju faleminderit për praninë në festën e 10-vjetorit!", ka thënë presidenti Thaçi. Ai ka shtuar se Austria është përkrahëse dhe asgjë nuk i lëkund marrëdhëniet e mira

ndërmjet dy shteteve.

Ndërsa ish-kryetari i Kuvendit të Austrisë, Andreas Khol, ka urrear presidentin dhe popullin e Kosovës për dhjetëvjetorin e pavarësisë. "Herën e parë kam qenë në Kosovë në vitin 1991 dhe kam kuptuar pse Kosova kërkon liri dhe pavarësi. Më bën të lumtur të shoh një Kosovë krejt tjetër, të ndërtuar", ka thënë ai.

Hamza u premton përfaqësuesve më të mëdhenj të bizneseve reforma fiskale

Ministri i Financave, Bedri Hamza, para përfaqësuesve më të mëdhenj të bizneseve vendore dhe të huaja, ka premtuar vazhdimësi të reformave fiskale. Ndërkaq përfaqësuesit e bizneseve të huaja, Shpend Balijs dhe Fadil Hoxha, kanë përgëzuar ministrin Hamza për vazhdimësi të reformave në ekonomi

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 20 SHKURT - Ministri i Financave, Bedri Hamza, ka pritur të martën në takim kryetarin e Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gërxhaliu, kryetarin e Klubit të Prodhuesve të Kosovës, Astrit Panxha, drejtorin ekzekutiv të Këshillit të Investitorëve Evropianë, Shpend Balijs, dhe Fadil Hoxhën nga Oda Ekonomike Gjermane. Hamza në këtë takim ua ka dorëzuar atyre koncept-doku-

mentin që ka të bëjë me reformat e legjislacionit që rregullojnë fushën e biznesit, si Ligji për tatimin në pronë, Ligji për korporatat, Ligji për tatim në fitim dhe të ardhurave individuale, kodi i dogano, si dhe Ligji për Administratën Tatimore dhe procedurat. Ministri Hamza pas takimit ka deklaruar se efektet e masave të reja fiskale për vitin 2018 janë duke u zbatuar sipas planit. Ai ka apeluar te përfaqësuesit e bizneseve që të kontribuojnë me rekomandimet e tyre deri më 5

mars. Hamza ka folur edhe për masat mbrojtëse për produkte, por nuk ka treguar se cilat produkte do të mbrohen. "Kemi grup produkte që do të mbrohen në Kosovë nga importet e huaja, kryesisht nga ato aziatike. Ne përveçse kemi qëllim për t'i mbrojtur prodhuesit, kemi qëllim edhe për t'i mbrojtur qytetarët", ka thënë ministri Hamza. Ai ka folur edhe sa i përket raportit që ka pranuar nga Komisioni për Lirim nga Tatimi Doganor, Akciza dhe TVSh-ja. "Deri më 15 shkurt komisioni ka marrë 150 vendime për lirim nga tatimi doganor, në shqyrtim janë 50 vendime të reja si dhe kemi të parashtruara edhe 80 kërkesa të reja të cilat janë në pritje për shqyrtim nga komisioni. Në total kemi 280 vendime, ndërsa vitin e kaluar kemi pasur 220 vendime për

lirim nga TVSh-ja. Pra, është një numër në rritje që na jep indikacion se kemi rritje të veprimtarisë së prodhimit dhe se efektet e masave fiskale po shihen me shtim të rritjes së prodhimit", ka deklaruar Hamza, duke shtuar se janë të kënaqur me efektet e reformave fiskale që janë bërë deri më tani. Ndërsa sa i përket pakos së ligjeve tatimore, ministri Hamza ka thënë se Ministria e Financave ka përfunduar të gjitha konsultimet e brendshme. Ai ka bërë me dije se nga e marta koncept-dokumenti do të jetë publik për komente. Kryetari i OEK-ut, Safet Gërxhaliu, ka thënë se duhet të bëhen kampanja vetëdijësuese dhe mos të politizohen reformat fiskale, si dhe mos të amandamentohen ligjet të cilat shkojnë në favor të prodhuesve të caktuar. Kurse drejtori ekzekutiv i

Këshillit të Investitorëve Evropianë, Shpend Balijs, ka thënë se masat e ndërmarra nga Qeveria e Kosovës do të jenë të favor të investitorëve të huaj. "Ne emër të Këshillit të Investitorëve Evropianë e falënderoj ministrin Hamza për masat e ndërmarra", është shprehur Balijs. Edhe kryetari i Klubit të Prodhuesve të Kosovës, Astrit Panxha, ka thënë se me këto masa të ndërmarra po krijohet një ambient më i mirë i të bërit biznes në Kosovë. Sipas tij, luftimi i ekonomisë informale duhet të jetë prioritet i Qeverisë që të kemi një treg të balancuar në Kosovë. Po ashtu, edhe përfaqësuesi i Odës Gjermane, Fadil Hoxha, ka shprehur falënderimet e tij për reformat fiskale. Ai ka thënë se bizneset e huaja dhe investitorët janë imazh i Kosovës në arenën ndërkombëtare.



Hamza: Mbetemi të përkushtuar për thellimin e bashkëpunimit me BERZh-in

PRISHTINË, 20 SHKURT - Ministri i Financave, Bedri Hamza, ka pritur të martën në takim drejtorin e Konsituencës në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), Ove Jensen, me të cilin ka diskutuar për aktivitetet momentale të BERZH-it në Kosovë. Hamza ka thënë se Kosova si një

vend në zhvillim ka nevoja të mëdha për investime dhe, sipas tij, BERZH-i mbetet një institucion mjaft i rëndësishëm për sigurimin e financimit për projektet zhvillimore, si në sektorin publik po ashtu edhe për atë privat. "Gjatë vitit 2017 është arritur rekordi i investimeve të BERZH-it në Kosovë, me një

investim vjetor 81 milionë euro, ndërsa investimet kumulative të BERZH-it kanë arritur në vlerën 313 milionë në 55 projekte të ndryshme", ka thënë Hamza. Ndërsa drejtori i Konsituencës në BERZH, ku bën pjesë edhe Kosova, Ove Jensen, ka ofruar përkrahjen e këtij institucioni për shtetin e Kosovës.



Haradinaj: Ky është vit i Trepçës



Me rastin e 29-vjetorit të grevës së minatorëve, kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se viti 2018 do të jetë vit i "Trepçës" sa i përket definimit të statusit dhe funksionimit të bordit menaxhues. Ai ka thënë se viti 1989 ishte një ngjarje e madhe që lëkundti drejtimin e proceseve të mëtejme falë së drejtës që kërkuan 1 300 minatorët e ngjuar në thellësi të horizonteve të Trepçës në atë kohë

EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

MITROVICË, 20 SHKURT - Këtë vit shënimi i Javës së Minatorëve është mbajtur nën perkujdesjen e kryeministrit të Kosovës,

Ramush Haradinaj. Duke folur për 29-vjetorin e grevës së minatorëve, Haradinaj ka thënë se viti 1989 ishte një ngjarje e madhe që lëkundti drejtimin e proceseve të mëtejme falë së drejtës që kërkuan 1 300 minatorët e ngu-

juar në thellësi të horizonteve të "Trepçës" në atë kohë. "Këtë vit e kemi shpallur vit të 'Trepçës'. Statuti i 'Trepçës' është në hartim e sipër. Bordi i 'Trepçës' është në përgatitje e sipër. Do ta ketë edhe përfaqësuesin e punë-

torëve. Do të bëhet edhe Ligji për 'Trepçën', ka thënë ai.

Kryeministri Haradinaj ka pohuar se Qeveria do të punojë që "Trepça" të jetë e aftë të operojë vet. "Është normale që kemi vështirësi, por do t'i menaxhojmë me sukses. Do të punojmë kujdesshëm që aktivizimi i 'Trepçës' në të gjitha kapacitetet e veta mos të jetë fatkeqësi e asnjë qytetari të Kosovës, as e serbëve të veriut. Pra, nuk është fare aktivizimi i 'Trepçës' i dedikuar kundër askujt, por për të gjithë", ka thënë kryeministri

Haradinaj.

Haradinaj u ka bërë thirrje për ndihmë të gjithë aktorëve të përfshirë në këtë proces, në mënyrë që të aktivizohen resurset dhe "Trepça" ta zhvillojë Kosovën. "Jam thellë i bindur se e kemi të drejtën të lëvizim, që këto veprime të rezultojnë me mundësi, me kapacitetin veprues të Trepçës për operim, për partneritet dhe për zhvillim. Ky është lajm i mirë për të gjithë ata që e duan zhvillimin e Kosovës. Ta rikthejmë 'Trepçën' si i takon Kosovës", ka thënë Haradinaj.

Beqaj: Kosova, vend atraktiv dhe me potencial për investitorët e huaj

PRISHTINË, 20 SHKURT - Ministri i Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, po merr pjesë në "Forum Botëror për Investime të Bizneseve Engjëj" që po mbahet në Stamboll të Turqisë, me qëllim të fuqizimit të zhvillimit ekonomik në botë.

Ministri Beqaj në panelin kryesor të këtij forumi ka folur për temën "Financimi i inovacionit përmes ndikimit të investimeve në

Evropën Juglindore". Në fjalën e tij, ministri Beqaj ka theksuar përparësitë dhe potencialin e Kosovës për tërheqjen e investimeve nga bizneset engjëj. "Kosova është vend atraktiv dhe me potencial të madh për investime nga investitorët e huaj", ka deklaruar Beqaj.

Po ashtu, ministri Beqaj ka prezantuar para të pranishmëve të arriturat dhe sukseset e Qeverisë së Kosovës, komunitetit

të biznesit dhe organizatave të ndryshme që kanë dhënë rezultate, duke ndikuar në zhvillimin e bizneseve dhe ndërmarrësisë. Ministri Besim Beqaj ka folur edhe për angazhimin dhe përkushtimin e tij në udhëheqje të Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë për mbështetje të ndërmarrësve të rinj dhe lehtësira që do t'u ofrohen inovatorëve për financimin dhe zhvillimin e ideve inovative.



Vdesin tri vajza në një aksident komunikacioni në Istog

Istog, 20 SHKURT - Policia e Kosovës ka njoftuar se të martën në mbrëmje rreth orës 23:00, në fshatin Baicë të Istogut, ka ndodhur një aksident trafiku ndërmjet dy veturave. Sipas policisë,

deri te aksidenti ka ardhur nga mospërshtatja e shpejtësisë së lëvizjes me kushtet e rrugës. "Lëndime trupore kanë pësuar të dy ngasësit dhe pesë pasagjerë. Mjeku kujdestar në Spitalin

e Pejës ka konstatuar se dy viktimat femra janë pa shenja jete, ndërsa viktimat e tretë, po ashtu femër, ka ndërruar jetë në OKUK - Prishtinë", është thënë në njoftimin e policisë.



Haradinaj: Komuniteti ashkali, besnik ndaj Kosovës

PRISHTINË, 20 SHKURT - Nën përkujdesjen e kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj, është organizuar të martën në Prishtinë konferenca ceremoniale për festimin e Ditës së Komunitetit Ashkali. Në hapje të kësaj konference, Haradinaj ka thënë se ashkalinjtë jetojnë me shënjë në Kosovë dhe se janë besnikë ndaj Kosovës. "Ashkalinjtë e kanë historinë e vet dhe simbolin kombëtar,

flasin gjuhën shqipe dhe kanë traditën e njëjta me popullin shqiptar", ka thënë Haradinaj, duke shtuar se ky komunitet pas luftës ka qenë aktiv në jetën politike dhe shoqërore të Kosovës. Haradinaj duke shprehur urimin për Ditën e Flamurit të Ashkalive, 15 shkurtin dhe që në Kosovë ka nisur të shënohet që 15 vjet, ka thënë se ngjyrat e flamurit ashkali simbolizojnë paqen, besnikërinë, por edhe

unitetin. Ai falënderoi këtë komunitet për një angazhim të sinqertë për avancimin e Kosovës.

Ndërsa Danush Ademi dhe Etem Arifi, përfaqësues të komunitetit ashkali në Kuvendin e Republikës së Kosovës, kanë thënë se komuniteti ashkali është përfshirë mirë në Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke i mbrojtur të drejtat e komunitetit në çdo aspekt.

Rikthehet flamuri kombëtar te 'Rrethi'

PRISHTINË, 20 SHKURT - Për nder të dhjetëvjetorit të pavarësisë, flamuri i shtetit të Kosovës ishte vendosur te rrethrotullimi në Prishtinë. Pas përfundimit të festës, flamuri shtetëror është hequr dhe është vendosur përsëri ai kombëtar. Vendimi për vendosjen e flamurit kombëtar është marrë të martën nga kryeministri Ramush Haradinaj.



Bahtiri interesohet për themelimin e një qendre shëndetësore

MITROVICË, 20 SHKURT - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka pritur të martën në takim pronarin e Kolegjit "Heimere", Fredrich Heimeren. Gjatë këtij takimi shefi ekzekutiv për Kosovë i këtij kolegji, bashkëpronari Petrit Beqiri, ka njoftuar kryetarin Bahtiri për synimet e këtij kolegji, i cili, përpos qytetit të Prishtinës, planifikon të shtrihet edhe në qytetin e Mitrovicës, duke hapur kështu

Qendrën Multidisiplinare Shëndetësore.

Sipas pronarit të Kolegjit "Heimere", Fredrich Heimeren, qëlimi kryesor i themelimit të kësaj qendre do të jetë përmirësimi i shëndetit të qytetarëve të Mitrovicës. Gjatë këtij takimi të pranishmit diskutuan me gjerësi në lidhje me lokacionin se ku do të ndërtohet Qendra Multidisiplinare Shëndetësore.

Të gjitha rrugët janë të kalueshme në Malishevë

MALISHEVË, 20 SHKURT - Pavarësisht prej reshjeve të vazhdueshme të borës në dy ditë e fundit, të gjitha rrugët në Komunën e Malishevës janë të kalueshme, përfshirë edhe rrugët në fshatrat e thella malore.

Nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, ka takuar banorët e fshatrave Berishë dhe Fshat i Ri, ku ka bërë me dije se kompania për mirëmbajtjen e rrugëve gjatë dimrit ka dalë në terren dhe po kryen

punën e saj. Banorët janë shprehur të kënaqur me mirëmbajtjen e rrugëve, pasi në asnjë rast nuk janë bllokuar nga bora, edhe pse temperaturat janë të ulëta në këto fshatra dhe reshjet e borës janë më të mëdha.



"MENDIME TË ZGJEDHURA PËR ADEM DEMAÇIN" (9)

ADEM DEMAÇI DHE KOSOVA JANË NJË



Selatin NOVOSELLA

184. Naim Hoxha: Adem Demaçi si kryetar i Kuvendit të Kosovës, ide e mençur dhe e drejtë. Ideja për zgjedhjen e Adem Demaçit kryetar të Kuvendit të Kosovës është ideja më e mençur dhe më e drejtë. I jap vetës guxim të them se këtë post me kaq rëndësi s'e meriton kush më shumë se sa Adem Demaçi, natyrisht pa mohuar angazhimin e shumë intelektualëve dhe përfaqësuesve të tjerë për çështjen tonë kombëtare.

185. Naim Maloku, komandant i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës: Adem Demaçi do t'i shpejtoj disa procese politike në Lëvizjen tonë Kombëtare.

Duke pasur parasysh autoritetin e lartë që Adem Demaçi e gëzon në popull, mendoj se prej tij pritët që t'i shpejtoj disa procese pozitive në Lëvizjen tonë Kombëtare për çlirim. Në radhë të parë, nga Demaçi pritët që të veprojë dhe të ndikojë pozitivisht në formimin e institucioneve shtetërore të Kosovës. Mendoj se roli i Demaçit duhet dhe pritët të jetë që të ndihmojë që UÇK-ja të futet në suazat e institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës.

186. Naim Tërnavë, myfti i Bashkësisë Islame të Kosovës: Adem Demaçi, vizionar largpamës Adem Demaçi, me veprimtarinë dhe qëndrueshmëri të tij dinjitoze, do t'i takojë vendi më meritor në analet e historisë sonë kombëtare, si personalitet që me vizionin e tij largpamës iu parapriu ngjarjeve historike, dëshmitar të cilave jemi ne sot.

187. Nait Hasani, deputet i parlamentit të Republikës së Kosovës: Adem Demaçi dhe Kosova janë një. Të shkruash për Adem Demaçin nuk është lehtë. Sepse Ai dhe Kosova apo Kosova dhe Ai janë Një. Njëri pa tjetrin nuk shkojnë. Sepse Demaçi dhe Kosova kanë një emërues të përbashkët. Kosova Demaçit i dha jetën dhe nderin. Ai Kosovës veten.

188. Nermin Vlora, pinjolle e familjes historike Vlora: Adem Demaçi e ndiente veten të lirë, megjithëse i lidhur me zinxhir.

Njëzet e tetë vjet burg, 28 vjet të hequra nga jeta e një burri vetëm pse ishte shqiptar, shkrimtar dhe i ditur, prandaj dy herë i "rrezikshëm". I rrezikshëm se i përkiste një etnie autoktone në ato troje. Por, Adem Demaçi e ndiente veten të lirë, megjithëse i lidhur me zinxhir: shpirt i tij kishte mësuar të dërgonte mendimin e tij njerëzve të lirë, dashamirës të mosdhunës e

të paqes.

189. Nexhat Daci, anëtar i Këshillit Qendror të Lidhjes Demokratike të Kosovës: Adem Demaçi të zgjedhet deputet i Kuvendit të Kosovës Adem Demaçi do t'i bënte nderë si deputet çdo Parlamenti të shteteve evropiane. Pse të mos e ketë këtë nder Parlamenti i Kosovës?

190. Nexhat Rexha, shkrimtar: Adem Demaçi, sinonim i sakrificës Personaliteti i Adem Demaçit në veprat e Selatin Novosellës ofron e mundëson përjetimin e njeriut që ka sakrifikuar dhe ia ka dalur bashkë me popullin e tij të tejkalojë shumë udhëkryq, të cilat në vete kanë bartur përgjegjësi nga më të ndryshmet.

191. Nikë Xheloshi, zëvendëskryeministër në Qeverinë e Kosovës në ekzil: Adem Demaçi synonte formimin e Asamblesë Kombëtare

Adem Demaçi, më 21 shtator 1998, pohonte: "do të krijoj një Asamble të përbashkët dhe nga ajo asamble të dalë mandatarin për formimin e një qeverie, t'i jepet mandati një njeriu që është i zoti për të marrë mandatin e një qeverie që do të ishte për të punuar në Kosovë dhe nga këto organe do të formohet grupi negociator me njerëz kompetent që do të kishin rreth vetes ekspertët e nevojshëm shqiptarë".

194. Nikolla Mazura, bashkëvuajtës i Adem Demaçit në burg: Të burgosur politik më dinjitoz se Adem Demaçin nuk kam parë

Në burgjet e Jugosllavisë, si i burgosur politik kroat, i kam mbajtur 22 vjet burg. Gjatë kësaj kohe asnjëherë nuk kam takuar të burgosur më dinjitoz se sa Adem Demaçin.

195. Noel Malkolm, historian: Adem Demaçi përfaqësonte Lëvizjen politike më të vjetër proti-

ranase

Lëvizja më e vjetër protiranase, që ka vepruar në Kosovë, "Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve", u themelua vetëm në fillim të viteve gjashtëdhjetë; lideri i saj, Adem Demaçi, pretendonte se kishte siguruar një anëtarësi prej afro 300 vetash, shumë prej të cilëve u arrestuan (bashkë me të) më 1964.

196. Nufri Lekaj, veprimtar i çështjes kombëtare: Adem Demaçi, në vitin 1994, ishte kandiduar për Çmimin Nobel për Paqe

Në vitin 1994, pesë deputetë të Parlamentit të Norvegjisë e kandiduan Adem Demaçin për Çmimin Nobel për Letërsi dhe të njëjtin vit ai kandidohet edhe për Çmimin Nobel për Paqe. Në vitin 1995 ai nderohet me Çmimin Leo Eitinger për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut nga Universiteti i Oslos.

197. Paskal Milo, ministër i Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë: Adem Demaçi i kupton vështirësitë në Shqipëri

Adem Demaçi, më 5 janar 1999, më tha se politikanët shqiptarë të Kosovës janë realist dhe me gjithë dëshirën e tyre që vendi amë, Shqipëria, të luante një rol edhe më të madh për zgjidhjen e çështjes së Kosovës, ata i kuptojnë vështirësitë që po kalon Shqipëria.

198. Peter Kurman, shkrimtar: Lirimi i Adem Demaçit nga burgu do të jetë gëzim për shkrimtarët suedezë

Dua të them se në atë kohë kur Adem Demaçi do të dalë nga burgu, për ne shkrimtarët suedezë, do të jetë një gëzim tepër i madh.

199. Pishtar Lutfiu, ministër i Arsimit të Republikës së Maqedonisë: Pa Adem Demaçin s'mund të imagjinohet e kaluara dhe e sotmja shqiptare. Nderimi që i bëhet Adem Demaçit është një rishikim i vetvetes, të

kaluarës dhe të sotmes, pasi që e kaluara dhe e sotmja nuk mund të imagjinohet pa ideat e Adem Demaçit, si në Kosovë ashtu edhe në Maqedoni dhe mbarë popullin shqiptar kudo që jeton.

200. Pjetër Arbnori, kryetar i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë: Adem Demaçi, simbol i qëndrueshmërisë

Ju, i dashur Adem, jeni nga ata intelektualë e luftëtarë shqiptarë që tërë jetën ia keni kushtuar, pa më të voglën rezervë, idealit të shenjtë të lirisë. Keni mposhtur burgun gati tridhjetëvjeçar brenda hekurave mbyjtës të shovinistëve serbomëdhenj. Jeni kthyer në simbol të qëndrueshmërisë e ndershmërisë e urtësisë popullore dhe tash qëndroni kryelartë, në rreshtat e para, të rezistencës paqësore që populli heroik i Kosovës të fitoj, hap pas hapi, të drejtat e veta njerëzore e kombëtare dhe të bëjë realitet aspiratat e natyrshme për liri, pavarësi e bashkim kombëtar.

201. Prend Buzhala, shkrimtar: Adem Demaçi dha intervista të panumërta për shtypin kombëtar dhe botërorë

Gjatë viteve '90-ta, pas liritimit nga burgu i tretë, Adem Demaçi ka dhënë intervista të shumta jo vetëm në mediet shqiptare, por edhe në mediet e shumta evropereëndimre e botërore, në të cilat jepën komente, zëbrithme e argumente për gjendjen e shqiptarëve nën Serbi e në shtete tjera sllave.

202. Qani Mehmedli, publicist: Adem Demaçi, projektuesi dhe protagonist më frymëzues i lirisë së Kosovës

Bota shqiptare më shumë se gjashtëdhjetë vjet ballafaqohet me fenomenin Demaçi. Rreth dyzet vjet duke ndjerë madhësinë e tij në heshtje, kurse mbi njëzet vjet të tjera kur Demaçi nuk flet më nga burgu, por fol, siç shprehet ai, nga një burg më i madh në botë dhe fol edhe tani që Kosova, më në fund, e fitoi lirinë, ndonëse jo në përmasat

siç e kishte dashur dhe projektuar protagonistin më frymëzues i saj, Adem Demaçi.

203. Qazim Berisha, shkrimtar: Adem Demaçit Zoti ia shtoi shëndetin dhe ia zgjati jetën

Adem Demaçi për lirinë e Kosovës e ofroi edhe jetën, por mortja s'e mori. Ai, për lirinë e Kosovës e ofroi shëndetin, por Zoti ia shtoi edhe më shumë.

204. Qemal Krasniqi, profesor: Adem Demaçi, në fatqësinë e tij, shihte të ardhmen e atdheut. Për të arritur deri te çlirimi i Kosovës na duhej urtësia e Adem Demaçit, zemërgjerësia e tij, na duhej guximi i tij, na duhej dashuria e tij për atdheun, na duhej zgjuarsia e tij, na duhej durimi i tij. Sepse ai, në fatqësinë e tij, shihte të ardhmen e atdheut, shihete lavdinë e dëshmorëve.

205. Qemal Minxhozi, ambasador i Shqipërisë në Kosovë: Adem Demaçi ka lindur në palët e flamurit

Vendlindja e Adem Demaçit nuk është thjesht Kosova. Adem Demaçi ka lindur në palët e flamurit kombëtar. Me Adem Demaçin krenohemi të gjithë, sepse ai ishte, është dhe do të mbetet simbol i krenarisë shqiptare. Adem Demaçi ka qenë dhe mbetet përfaqësuesi më integruar, më i duartrokatur, më i mbështetur prej të gjitha figurave që ka pasur historia e Kosovës.

206. Qerim Lita, zëvendësdrejtor i Arkivit Shtetëror të Maqedonisë: Adem Demaçi, organizator rrallë i Lëvizjes Kombëtare

Adem Demaçi, në vitin 1963, pasi vendosi lidhje me disa atdhetarë të tjerë nga Prishtina, Peja, Gjakova, Mitrovica, Gjilani etj., për një kohë shumë të shkurtë arriti ta formojë organizatën ilegale, e cila mori emrin "Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve".

207. Qerim Pllana, shkrimtar: Të gjithë disidentëve evropian, përveç Adem Demaçit, iu mundësua zgjedhja në postet më të larta shtetërore

Të gjithë kolegëve, ish-të burgosur politikë, të Adem Demaçit në Shqipëri, Kroaci, Bosnje, Sloveni, Vojvodin, Mal të Zi, Maqedoni, Gjermani Lindore, Çeki, Slovaki, Rumani, Bullgari etj., pas rënies së komunizmit dhe Murit të Berlinit, duke filluar nga Vasilav Haveli në Çeki, iu mundësuan postet - kryetar qeverie, president ose kryetar të kuvendeve, përveç Adem Demaçit!

208. Ramadan Avdiu, veprimtar i dalluar i çështjes kombëtare: UDB-ja ishte kujdesur të zhdukte të gjitha fotot e Adem Demaçit

Adem Demaçi, prej vitit 1958 e deri në vitin 1990, nuk përmendej shumë publikisht, sepse çdo apostrofim i emrit të tij do të thoshte rrezik për burgosje. Mediat nuk publikonin asnjë foto të tij, përveç shtypit ilegal, kurse UDB-ja ishte kujdesur për të zhdukur të gjitha fotot e Adem Demaçit.

(Vijon)



DEMARKACIONI DO TË KALUJË, PO PASTAJ KË DO TA MBËRTHEJË LEMZA?!



**Behxhet Sh.
SHALA-BAJGORA**

Demarkacioni po ratifikohet para se të falimentohet. Më në fund po ratifikohet Marrëveshja për Demarkacion të kufirit me Malin e Zi, i cili ishte tërhequr zvarrë për tre vjet duke u përdorur e më shumë keqpërdorur nga të gjithë; kush më shumë e kush më pak. Përnjëherë i lamë të gjitha punët e tjera dhe të gjithë u bëmë njohtë të demarkacionit në kohën kur pjesa më e madhe nuk ka kapacitet ta interpretojë as një hartë gjeografike të klasave të pesta. Hashimi i përndritur dhe "Bukuroshja" e përhitur, së bashku me Skenden e Llapit, e nënshkruan Marrëveshjen për Demarkacion, besoj pa e lexuar fare. Hashimi është erudit dhe nuk humbet kohë duke lexuar marrëveshje sepse ato ia shkruajnë të tjerët sikur që edhe Zezëdita, e pasionuar pas modës dhe blerjeve, në vend se të lexojë marrëveshje të shkruara nga burokratët evropianë, i shfleton me pasion "romanët" e Dolçe Gabanës, Armanit, Versaçes, Iv Sen Loranit, Diorit, Mek Kuinit, Pradas dhe klasikëve të tjerë të modës. Skenda ka një pozicion neutral në vendimmarrje, e nënshkruan çka i kërkon shefi. Shefi, alias Hashimi, e formoi një komision qeveritar për ta siguruar një faturë arsyetuese për aventurat e Brukselit, kurse komisioni qeveritar, duke menduar se po i shërben vendit, bënte çka i thoshte shefi. Realisht, nga gjendja që e kemi sot po del se shumë më largpamës, jo vetëm shkak i dioprisë, po del të jetë Hashim Shefi se të gjithë udhëheqësit e rajonit që nuk pranuan që Demarkacioni të futet si kusht për liberalizim të vizave. Hashimi na futi mirë e mirë Demarkacionin si kusht për viza e tash po e sulmon BE-në se na ka lënë rrugëve para ambasadeve dhe se e paskan mashtruar Hashimin dhe për këtë arsye Hashimi i njohur si besnik dhe

shumë i sinqertë, nuk u doli në fjalë qytetarëve të Kosovës për të cilët aq shumë u sakrifiku dhe të cilët edhe më shumë e duan Hashimin president. Thonë se vakti e hanë kashtën dhe se vjen koha që Hashimi nuk e mbanë fjalën, nuk do të parashihej sa me imagjinatën më të shëmtuar dhe shpërfytyruar. Presioni për ratifikim të Demarkacionit ishte dhe është aq i madh e i fuqishëm sa që nuk mund të kundërshtohet. Komandanti legjendar Adem Jashari nuk është më gjallë dhe minjtë po hedhin valle. Baca i Madh Adem Demaçi nuk mund të kundërshtojë dhe për ngushëllim e ka se nuk e dëgjonin as edhe kur ishte në gjendje të kundërshtonte. Vetëvendosja, e dhënë pas aferave seksuale, një pjesë pas hajnisë dhe luftës për pushtet, vetëm formalisht po e kundërshton demarkacionin. Po i mbron më shumë disa kufij të kënaqësisë. Edhe bashkimin kombëtar, si armën më të fuqishme për manipulim me masa për marrje të pushtetit, e zbuti se është për bashkim kombëtar, i cili nuk do të kundërshtohet nga shtetet e BE-së. BE-ja më parë do ta pranoi bashkimin e Kosovës me Serbinë se bashkimin me Shqipërinë. Sa dhuna u përdorë kundër Policisë së Kosovës në kundërshtim të demarkacionit, sa xhamat e Qeverisë dhe Kuvendit u thyen për këtë kauzë, sa njeri u fye dhe u sulmua duke e pushkatuar nëpër rrjete sociale, sa dëmet u bënë, materiale dhe jomateriale në kundërshtim të demarkacionit dhe në fund po votohet ratifikimi i Marrëveshjes me Malin e Zi. Në çdo shkrim jam deklaruar se, për dallim nga shumica, jam injorant i certifikuar për mosnjohje të demarkimit të kufijve dhe tërë kundërshtimin tim e kam ndërtuar në pësimet nga e kaluara ku, në të gjitha zhvillimet e mundshme si në Evropë, Azi, Amerikë apo Afrikë, shqiptarët gjithmonë kanë humbur territoret. I kemi humbur territoret sikur blakçorët që i kanë humbur tokat e tyre në Llap. Kam thënë dhe po e përsëris, se kur të vijë koha ta bëjmë demarkimin me Serbinë, do të shkojmë dhe ta puthim çdo centimetër të kufirit me Malin e Zi dhe të gjithë malazezët. Unë deklarohej për malazeze. Në Ballkan po ven-

dosen kufijtë e përkohshëm për t'u rivizituar përfundimisht pas 20-25 vjetëve. Mirëpo, grabitqarët rreth Kosovës po krijojnë epërsi strategjike për Ditën D, kur do të vendosen kufijtë e rinj. Po e përsëris se ratifikimi i Marrëveshjes për demarkacion nuk është çështje patriotike shkak se kundërshtarët e demarkacionit dhe "mbrojtësit" e tërësisë territoriale të Kosovës kanë lidhje me patriotizëm aq sa kam unë lidhje me gruan e Zulfikar Ali Butos. Këta që po mundohen sot ta mbrojnë Kosovën, edhe shpirtin ia patën falë Jugosllavisë dhe Serbisë. Se nuk është çështje patriotike tregon fakti se deputetët që kërkonin bashkim me Çamërinë, sot herë e kundërshtojnë e herë e përkrasin demarkacionin. Kur këta patriotë të dëshmuar në vendosmëri nuk ngulin këmbë, mos vallë pritni nga unë të sakrifikohej si Jan Pallahu në Pragë. Rrugën për ratifikim të demarkacionit e hapi gjenialiteti i presidentit Thaçi që, si alkimist i dëshmuar, çdo gjë që e ka prekur me dorë e ka bërë m..jaltë, me një bisht që i shtohet marrëveshjes kryesore e që u nënshkrua me presidentin e Malit të Zi që gjithmonë thotë se Mali i Zi e ka ratifikuar marrëveshjen dhe se tash është çështje e brendshme e Kosovës. Sipas Hashimit, po del se më shumë peshë juridike ka bishti (shtojca) e marrëveshjes se vet marrëveshja! Ky aneks biseksual përngjanë me interpretimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës për Asociacionin e komunave serbe ku thuhej se është vërtetuar se Kushtetuta është shkelur në 24 raste, por se duhet të vazhdohet me formimin e Asociacionit. Vetëm ndërkombëtarët dinë të shkruajnë këso tekste të cilat vetëm dikush që ka punuar me ndërkombëtarët apo i mungojnë 5-6 dërrasa janë në gjendje ta kuptojnë. Prandaj e them se demarkacioni do të ratifikohet dhe duhet të ratifikohet ose të shkojmë te varri i Adem Jasharit dhe të kërkojmë që, edhe një herë të sakrifkohet për patriotët si puna ime dhe të tjerët siç janë deputetët e lavdishëm të Kuvendit të Kosovës të cilëve kurrë nuk u prenë sakica në një vend. Nuk duhet të kërkohej fajtorët për këtë, por duhet të angazhohemi që dëmi të jetë sa

më i vogël. Pa u dëmtuar nuk do të kalojmë sikur që u dëmtuam edhe me Maqedoninë në Debellde. Me injorancën time e them se Asociacioni i komunave serbe është shumë më i rrezikshëm se demarkacioni. Për këtë nuk kam asnjë dyshim. Më mirë është që deputetët shqiptarë të Kuvendit të Kosovës të merren vesh për ta defaktorizuar Serbinë e vogël në Kosovë - Lista Serbe, se të shpenzojnë energji për gjëra që nuk varen nga ata. Përfundimisht do të ndodhë ratifikimi i Marrëveshjes për demarkacion dhe kjo është e paevitueshme. Nuk ka aspak dallim kushtëzimi që ua bëjnë Alternativa dhe LDK-ja për të votuar demarkacionin nga kushtëzimi që ua bënë Lista Serbe. Demarkacioni ose duhet të votohet pa asnjë kushtëzim, ose nuk duhet të votohet fare. E unë jam i sigurt se do të votohet. A pajtohem a jo është diçka tjetër, mirëpo kjo është punë e përfunduar. Është e kotë t'i nxirrni sytë njëri-tjetrit, të fyeri me fjalë më të ulëta apo të fryheni dhe shfryheni me një patriotizëm folklorik! Përmbahuni se nuk dihet çka sjellë dita e nesërme. Rita Ora dhe Behgjet Pacolli: Kanë shumë gjëra të përbashkëta Rita me Gjetin, përveç bukurisë dhe sharmin. P. sh., unë do të zihesha pisk nëse duhet të deklarohem se cili është patriot më i madh, Rita apo Behgjeti. Për pasuri (materiale) Begja ia kalon Ritës, për pasuri shpirtërore është e kundërta. Që të dy janë simpatikë, varësisht nga këndi i vlerësimit. I bashkon edhe gjuha shqipe. Rita Ora tha se kupton shqip, por se nuk flet shqip. Te Begja është një situatë tjetër; Begja nuk e kupton shqipën, por përpigjet të flasë shqip. Që të dy janë entuziastë. Rita këndon dhe vallëzon bukur, kurse Begja noton për bukuri në të gjitha ujërat. Rita Ora e ka hapur zemrën, kurse Begja e ka hapur grazhdin në Hajvali. Hashim Thaçi propozoi ndërtimin e rezidencave institucionale në Hajvali, afër vëllamit të tij Begjës, kurse Begja si filantrop (dikush thotë mizantrop) e pranoi duke i ofruar partnerët më të besueshëm në Kosovë për kryerjen e punës, Ganinë dhe Rrahën, kurse financat do të udhëhiqeshin nga Besimi. Si njeri shumë i fjalës, i sinqertë,

sidomos gjatë muajit të prillit, koordinator do të ishte Hoxha i Suharekës. Njerëz më të besueshëm, më të sinqertë, më të drejtë dhe më të fjalës nuk i gjeni sot në Kosovë. Pastaj, këta kanë përkrashje politike; të AKR-së dhe PDK-së. LDK-ja paloset si gjithëherë. Lista serbe edhe ashtu është pjesë e lojës. Vetëvendosja ka kaluar në tarikatën e bektash-injve. Shqiptari Rama dhe kosovari Dulla: Kur Edi Rama ia bënte 8 me 2 Vuçiqit në Beograd i këndonin të gjithë, madje edhe këngëtarja e përmasave ndërkombëtare, Linda Morina. Kur Edi Rama flet për bashkim kombëtar reagon Brukseli dhe pinjollja e saj, Serbia. Kur Edi Rama thotë se pas 10 vjetëve shqiptarët mund ta kenë një president të përbashkët reagonjë Vuçiqi, Daçiçi, Vulini, Imer Mushkolaj, Brukseli dhe Behlul Beqaj dhe patriotët e tjerë kosovarë, emrat e të cilëve nuk po më kujtohen. Po thonë se Edi Rama po i bie çiftelisë patriotike me plis të bardhë në kokë. Janë mësuar ta luajnë dhe ruajnë shiri kollën dhe shajkaçën, me shlivovicë në dorë. Edi Rama bëri mirë që e tha atë që e tha në Prishtinë dhe do të bënte shumë keq po mos ta thoshte këtë. BE-ja ia miklon koqet shovinistit Vuçiq që gjithmonë flet dhe angazhohet për Serbinë e Madhe duke e bërë Kosovën edhe më të vogël, ndërsa e kritikon Ramën që flet për një të drejtë natyrore që e ka shkruar edhe Zoti, e drejtën e bashkimit kombëtar të një populli që është ndarë dhunshëm dhe që po dhunohet edhe sot duke ia mohuar këtë të drejtë. Bashkimi është i pashmangshëm, proces që nuk ndalet dhe nuk jemi ne ata që e vendosim. Mund ta ngadalësojmë procesin, por jo edhe ta ndalim. Të gjithë, ndërkombëtarët në radhë të parë, thonë se veriu i Kosovës sundohet nga krimi i organizuar dhe Serbia, por nuk lejojnë që Kosova ta shtrijë autoritetin atje. Do të pyetenin pse! Shumë shpejt do ta merrni vesh! Doli qesharak Dulla në përpjekje që përmes kritikave të Ramës të fuqizohet politikisht. Është rregull i shkruar dhe i pashkruar se ai që gjuan miza, nuk mund të gjuajë edhe shqiptonja. Dulla është gjuetar i mizave. Kaq!

Lavrovi: Perëndimi po rrit tensionet në Ballkan

Ministri i Jashtëm i Rusisë, Sergei Lavrov, tha se vendet "anti-ruse" në Perëndim po i bëjnë shtetet e Ballkanit të zgjedhin midis Perëndimit dhe Rusisë, si kusht për t'iu bashkuar Bashkimit Evropian dhe NATO-s



MOSKË, 20 SHKURT - Ministri i Jashtëm i Rusisë, Sergei Lavrov, akuzoi Shtetet e Bashkuara dhe disa vende evropiane për nxitjen e tensioneve Lindje-Perëndim në Ballkan. Në një intervistë për agjencinë serbe të lajmeve "Beta", Lavrov tha se vendet "anti-ruse" në Perëndim po i bëjnë shtetet e Ballkanit të zgjedhin midis Perëndimit dhe Rusisë, si kusht për t'iu bashkuar Bashkimit Evropian dhe NATO-s.

ushqejë lidhje të ngushta me Moskën dhe ka thënë se nuk do t'u bashkohet sanksioneve ekonomike të BE-së kundër Rusisë për shkak të agresionit të saj në Ukrainë.

Beogradi, po ashtu, nuk ka bërë përpjekje t'i bashkohet NATO-s si vendet e tij fqinje Maqedonia dhe Mali i Zi, i cili i është bashkuar aleancës ushtarake vitin e kaluar. Politika neutrale ushtarake e Beogradit nuk është kundërshtuar haptazi nga udhëheqësit amerikanë apo evropianë.

Lavrov tha se detyrimi i vendeve të Ballkanit për të zgjedhur anë është "politikë shumë e gabuar" dhe se Rusia synon t'i mbajë interesat dhe lidhjet e saj me vendet si Serbia. Bashkimi Evropian, së voni, ka caktuar vitin 2025 si datë për pranimin e mundshëm të Serbisë dhe Malit të Zi në radhët e tij.

Një ligjëvënës amerikan, i cili ka vizituar Serbinë vitin e kaluar, ka thënë se për ta siguruar rrjedhën e investimeve nga Perëndimi, zyrtarët amerikanë duan të shohin indikacione se Serbia synon kah demokracitë perëndimore dhe kapitalizmi i tregut të lirë dhe anohet kundër agresionit që,

Udhëheqësit e BE-së u kanë caktuar kushte të vështira dy vendeve, veçanërisht për vendosjen e sundimit të ligjit, garantimin e të drejtave themelore dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve territoriale rajonale, por nuk kanë nxitur hapur politika anti-ruse si kusht për anëtarësim. Serbia, në veçanti, ka vazhduar të

fatkeqësisht, presidenti rus, Vladimir Putin, po demonstroi me Rusinë aktualisht.

Lavrov tha se detyrimi i vendeve të Ballkanit për të miratuar politikë anti-ruse është duke rritur tensionet në Evropë. "Uashingtoni dhe disa kryeqendra evropiane i dërgojnë ambasadorët e tyre në

Ballkan për këtë qëllim të saktë: mos jini miq me Rusinë, refuzoni bashkëpunimin me të në të gjitha fushat", tha ai.

Lavrov e dënoi, siç tha ai, historinë e Perëndimit për qendrën humanitare në Nish ku, sipas tij, aktualisht punojnë vetëm katër rusë.

Lavrov, i cili pritet ta vizitojë Serbinë sot (e martë), tha se Rusia do të vazhdojë ta bllokojë Kosovën nga pranimi në Kombet e Bashkuara derisa Beogradi dhe Prishtina të negociojnë një kompromis mbi çështjen e sovranitetit, ashtu siç kërkohet nga udhëheqësit serbë.

Trumpi kritikon ish-presidentin Obama për trajtimin e ndërhyrjes ruse



UASHINGTON, 20 SHKURT - Presidenti amerikan Donald Trump akuzoi përsëri të martën paraardhësin e tij Barak Obama se nuk bëri sa duhet për ta parandaluar ndërhyrjen ruse në zgjedhjet presidenciale të 2016-s.

Në komentet në "Twitter", Trumpi shkruante se Barack Obama mendoi se Hillary Clinton do të fitonte në zgjed-

hje, prandaj ai nuk donte t'i turbullonte ujërat. Por, shkruan presidenti Trump, kur zgjedhjet i fitoi ai, Donald Trumpi, "e gjithë loja ndryshoi dhe demokratët u kapën te preteksti i ndërhyrjes së Rusisë".

Ish-presidenti Obama ka thënë se nuk ka qëndruar indiferent ndaj ndërhyrjes ruse. Në një rast ai ka thënë se i kishte deklaruar presidentit rus të

hiqte dorë nga kjo ndërhyrje. Ndërkaq, ndihmësit e Prokurorit të Posaçëm Robert Mueller ngritën një akuzë të re kundër një personi që ata thonë se ka gënjyer hetuesit federalë në hetimin për Rusinë. Në një dokument gjykatë të paraqitur të martën në Uashington, personi i quajtur Alex Van Der Zwaan akuzohet për deklarata të rreme.

Prokurori special, akuza ndaj avokatit të konsulentit të Trumpit

UASHINGTON, 20 SHKURT - Prokurori special Robert Mueller ka ngritur një aktпадi ndaj një avokati që ka mashtruar hetuesit në lidhje me ndërveprimin e tij me ish-ndihmësin e fushatës së Trumpit, Rick Gates, në shtator të vitit 2016.

Paraqitja e aktpadisë është një dëshmi e mëtejshme e hetimit të Muellerit ndaj ish-kreut të fushatës së Trumpit, Paul Manafort, vetë Gates dhe punës së tyre për klientët aleatë të Rusisë.

Alex Van Der Zwaan, i cili pritet ta pranojë fajësinë të martën, akuzohet se ka gënjyer mbi dështimin e tij për t'i dorëzuar një komunikim "e-mail"-i zyres së prokurorit special. Në të ai ka folur me hetuesit mbi punën e tij me firmën ndërkombëtare ligjore "Skadden Arps" në vitin 2012, kur Manafort ndikoi që firma të kontraktonte nga ministri ukrainas i Drejtësisë për të përgatitur një raport mbi gjyqin e Yulia Tymoshenkos. Ajo është një prej politikaneve kryesore rivale të ish-presidentit ukrainas Viktor Yanukovich, i cili kishte



emëruar Manafortin dhe Gates si konsulentë politikë për më shumë se një dekadë. Pasi Yanukovich mposhti ngushtësisht Tymoshenkon në zgjedhjet presidenciale të vitit 2010, ajo u burgos me akuza për korrupsion, gjë që u konsiderua gjerësisht si sulm me motive politike. "Skadden" hartoi më pas një raport që doli në konkluzionin se procesi ishte i ligjshëm. Ajo u lirua menjëherë pas rrëzimit të Yanukovich në vitin 2014.

Akuza penale e prokurorëve shpjegon se si Van Der Zwaan foli me Gates dhe një person të pidentifikuar në shtator të vitit 2016 mbi raportin ukrainas dhe regjistroi telefonatat. Asokohe, Gates ishte ende duke punuar për fushatën e Trumpit.

NJË STUDIM NDRYSHE PËR NOLIN

(Dr. Entela Komnino, "E vërteta për Nolin", "GLPrint", Tiranë, 2017)



**Prof. dr. Sabile
KEÇMEZI-BASHA**

Ditë më parë në Tiranë e Tetovë u promovua libri studimor për jetën dhe veprën e Nolit "E vërteta për Nolin", nga studiuesja tani më veç e njohur, dr. Entela Komnino. Autorja Komnino për komunitetin shkencor edhe në Kosovë nuk është e panjohur. Ajo edhe më parë është prezantuar me shkrime publicistike, shkencore e hulumtime të ndryshme. Që në fillim duhet theksuar se Fan Noli pa dyshim është një nga figurat më të shquara të popullit shqiptar, i cili, si i tillë, ka zgjuar kërshërinë e shumë studiuesve të historisë, të huaj e shqiptarë, për ta trajtuar në suaza shkencore këtë figurë poliedrike.

I lindur më 6 janar 1882, në Ibriktepe të Trakisë, Theofan Stilian Noli, i njohur si Fan Noli ishte: shkrimtar, dijetar, diplomat, politikan, historian, orator dhe themelues i Kishës Ortodokse Shqiptare. Po ashtu, shërbeu si kryeministër dhe regjent i Shqipërisë më 1924, gjatë revolucionit të qershorit. Ishte njohës i shumë gjuhëve të huaja si: i greqishtes, latinishtes, turqishtes, anglishtes, frëngjishtes, e në moshë të shtyrë, ai mësonte edhe gjuhën ebreike. Shikuar në prizmin e historiografisë shqiptare, figura e Nolit, na del të jetë njëra nga figurat më komplekse të historisë tonë. Duhet thënë edhe këtë se, Noli si politikan dhe Noli si patriot,

ishin si dy anë të një medaljeje. Librin "E vërteta për Nolin", duke e shfletuar e lexuar, erdhëm në përfundim se është fryt i një hulumtimi të gjatë shkencore, që përfshin periudhat më të rëndësishme të jetës dhe veprës së Nolit.

Autorja Komnino, që në parathënie të librit, shprehet me të drejtë kështu, citoj: "Në fakt, Fan Noli, e ka filluar vetë pandehmën, duke i shkruar pas një kodi shkrimi dhe kuptimi të botës si prift, gazetar, shkrimtar, politikan, kritik letrar, diplomat, historian, përkthyes, madje dhe si muzikant. Të gjitha këto janë shfaqur për së jashtmi nën kuptimin gati organik që një prift është orator, një gazetar është orator, një politikan po ashtu", mbyllet citati.

Vërtet, libri i dr. Entela Komninos, përfshin një periud-

hë mjaft të gjatë kohore të jetës e veprës së Nolit, por megjithatë, ajo, me përkushtimin dhe durimin që e ka manifestuar si shkencëtare, del se, me një sukses të madh, ia ka arritur qëllimit, dhe, ia ka dalë mbanë, që figurën e Nolit, të na sjell në një shkrim, dhe studim krejt ndryshe, nga ato që jemi mësuar t'i lexojmë gjerë tani. Ajo, me sukses ka arritur që të rivalizojë të dhënat e bollshme, që ndoshta deri dje kanë qenë tabu për hulumtuesit.

Librin në fjalë, autorja paraprakisht e ndan në 26 tituj duke përfshirë këtu Hyrjen dhe literaturën. Komnino, me një kujdes të veçantë u qaset proceseve historike në jetën e Nolit, të cilat gjithashtu patën, edhe ndikimin më të madh në veprimtarin e tij, të cilat u paraprinë ngjarjeve të rëndësishme që sollën

ndryshime rrënjësore në shtetin shqiptar.

Rëndësi të veçantë Komnino i kushton pjesës "Koha me atdhe të përmbajtur" duke mos lënë anash as pjesët tjera të librit, duke na prezantuar shkaqet dhe pasojat e statusit të shkrimeve të Nolit dhe kufijve të tij.

Në librin "E vërteta për Nolin", autorja, në mënyrë të strukturuar na ofron një materie shumë komplekse dhe ndryshe, ngase këtë e bënë të mundur literatura e shumëllojshme të cilën e ka përdorë në tërë librin. Nga shkrimi, vërejmë se Komnino është njohëse e mirë e literaturës angleze e gjermane, çka të bënë të mendosh se një vepër e tillë gati-gati unikalë është pritur. Të dhënat dhe fjalori me të cilën është hartuar libri është i papërsëritshëm.

Në qoftë se fjala, në një vepër të


një shkrimtari, është pasqyra e vërtete, forma e mendësisë dhe e shpirtit, atëherë, është e drejtë, se veprat, shkrimet, vjershat dhe veprat e shqipëruara që shkroi Noli, përfaqësojnë në kuptimin e tyre simbolik, që nga fillimi e gjer në fund, një konfesion të vetëm, kredon e një njeriu e të një jete në shërbim të vendit të tij.

Dhe nga libri, vije mesazhi se, Noli është pa dyshim, një ndër personalitetet më të shquara të historisë kombëtare shqiptare. Dhe si i tillë, jo pakë, tërhoqi vëmendjen e historiografisë shqiptare dhe jo vetëm. E tërë veprimtaria e tij si, publicist demokrat, orator, njohës i mirë i fjalës së shkruar e të folur shqipe, politikan me një potencial të fuqishëm, iu kushtua jo vetëm mbrojtjes së interesave kombëtare por ashtu edhe luftës për ndërtimin e demokracisë së shtetit të ri shqiptar, gjë të cilën e vlerëson historiografia.

Duhet thënë se libri është i shkruar me një përkushtim të madh shkencor që në një mënyrë synon të rindërtojë shkencërisht një imazh të saktë e bindës dhe më ndryshe për Nolin dhe të vërtetën e tij. Autorja, pas përfundimit të librit, vë në pah se të gjitha çështjet që lidhen me historinë e Nolit, nuk mund të shtjellohen që të gjitha në mënyrë shteruese, por shpreson se në të ardhmen do të vazhdojë me të njëjtin intensitet për studime të tjera.

Ndërsa të dhënat e grumbulluara autorja i ka sintetizuar në mënyrë analitike, studimore dhe ka përdorur metodën krahasuese të shkrimit.

Dhe krejt në fund, të nderuar të pranishëm, përgëzojmë autoren Komnino, duke i uruar që në të ardhmen të na ofrojë edhe shumë shkrime të tjera për Nolin dhe jo vetëm për të.



Dëmtohet kalaja në Gjirokastrë

GJIROKASTËR, 20 SHKURT - Ministrja e Kulturës së Shqipërisë, Mirela Kumbaro, ka qenë në Gjirokastrë për t'i parë nga afër pasojat e çarjes së murit të kalasë, të evidentuara pak ditë më parë. "Konstatohet një zgjerim i çarjeve ekzistenciale me 1-1.5 cm. Natyrisht se çdo lëvizje që ndodh në terren reflektohet deri në lartësinë e mureve", ka thënë Kumbaro.

Ministrja ka theksuar se është duke u punuar për ndërhyrje në projekt dhe parandalimin e avancimit të këtyre çarjeve të hershme. "Inxhinierët janë duke punuar për ta bërë pro-

jektin e ndërhyrjes së fortifikimit dhe parandalimi i këtyre krisjeve që nuk janë të reja", ka thënë Kumbaro.

Ajo ka thënë se arkitekti dhe restauratori Agron Doraci e ka cilësuar situatën të rrezikshme, duke theksuar domosdoshmërinë e sistemimit të ujërave për shmangien e lagështisë në muret e kalasë, si një ndër faktorët dhe pasojat negative në të. Thellimi i çarjeve në pjesën juglindore të murit të kalasë së Gjirokastrës, ngriti alarmin për rrezikun e shembjes së saj si pasojë e erozionit dhe lëvizjeve tektonike që kanë përkeqësuar situatën.



Capital T i përshtatet kohës, zbardh "Instagram"-in



Reperi i njohur nga Kosova, Capital T, solli stilin e fotografive në të njëjtin vend, por në poza të ndryshme, i cili u kthye në trend në rrjetin social "Instagram". Duket se ai ka marrë vendimin për të hequr çdo postim,

duke lënë fotografinë e profilit të bardhë si dhe një postim të bardhë që nga 1 janari. Nuk dihet arsyeja e këtij vendimi pasi, së fundmi, solli albumin e tij të fundit 'Winter is here', të cilin e promovoi në rrjete sociale.

Dua Lipa "pushon" tregun e muzikës



Pas suksesit të hitit të saj "New Rules", edhe kënga e fundit e këngëtares shqiptare, Dua Lipa, është pëlqyer shumë nga fansat e saj. Vetëm një muaj pas publikimit të

videoklipit të këngës Idgaf, ajo ka arritur në 100 milionë pëlqime. Këtë fakt e ka bërë me dije vetë këngëtarja shqiptare Dua Lipa në rrjetin social "Instagram".



Rita në mbrëmjen e "Vogue Fashion"

Rita Ora ka bërë një emër të madh në modën botërore, sidomos në paraqitjet e saj të fundit. E tillë ishte edhe minifundi i saj ku ajo kishte vënë syze dielli, një veshje që u kon-

siderua veshja më interesante në mbrëmjen e "Vogue Fashion" për film. Rita, e cila është kthyer në Britani pas performancës shkëlqyese në Kosovë, ka shkëlqyer edhe në këtë ngjarje.

Fejohet me partnerin aktori britanik Russell Tovey

Russell Tovey ka konfirmuar fejesën e tij me ish-lojtarin e rugbyt, Steve Brockman. Në një intervistë për "MailOnline", aktori britanik Russell Tovey ka theksuar se ishte një gjë e paparashikuar tërësisht. "Jam shumë i lumtur dhe i paduruar për të festuar kur të kthehem në Londër", ka pohuar ai.



Katër vjet pa studiuesin e madh të historisë kombëtare, prof. dr. Shkëlzen Raça, të cilit rrallëkush mund t'i përngjasë

NË SHENJË KUJTIMI PËR SHKËLZEN RAÇËN



Shkruan: Prof. asoc. dr. Fahredin SHABANI

Prof. dr. Shkëlzen Raça njihet si studiuesi më i pasionuar në historiografinë tonë për marrëdhëniet shqiptaro-greke. Ky historian, përpos "Allfavitarit shqip" (1872) të Konstadin Kristoforidhit dhe të "Apologjisë" të Jani Vretos, do ta sjellë edhe "Ëvetarin" të Naum Panajot Haxhi Lazër Bredhit. "Ëvetari" i vitit 1845 i Naum Veqilharxhit ishte gjetur aty ku gjenden librat e rrallë shqip, në Athinë.

Historia jonë kombëtare është e pasur me figura meritore e të dinjitetshme me kontribut të çmuar e me peshë të përmasave kombëtare në fushën e historiografisë. Një vend të rëndësishëm në panteonin e historiografisë së marrëdhënies shqiptaro-greke zë edhe prof. dr. Shkëlzen Raça, i cili mund të klasifikohet si intelektual i devotshëm e si një atdhetar deri në vdekje erudit i përmasave përtej shqiptare. Mund të krahasohet me shumë intelektualë të shekullit XIX e tutje, për nivelin intelektual, por edhe për vizionin që kishte për të ardhmen e shqiptarëve në Ballkan. Ai vazhdoi denjësisht rrugën e rilindësve, si Hoxhë Hasan Tahsini, Hasan Prishtina, Mit'hat Frashëri, Faik Konica, Aleks Buda etj. Jeta intelektuale e patriotike e prof. Sh. Raça është me plot refleksione të jetës së një veprimtari të guximshëm për liri të hulumtimit shkencor, ndriçim të së kaluarës sonë. Ky personalitet i takon plejadës së historianëve, që kishin frymën e rilindësve tanë.

Ky personalitet do të jetë katalizator i një perceptimi të ri, i ideuar nga pararendësit e tij, që nga Rilindja Kombëtare. Duke rrumbullakuar kohën dhe jetën e dr. Raçës, mund të vijmë në përfundim se ai në aspektin profesional ishte tejet i përgatitur. Mirëpo pjesa më qenësore e tij ishte niveli prej një atdhetari, që për kohën së cilës i përkiste, i kalonte suazat e nivelit të Kosovës. Pra, për t'u shprehur në trajtën më përmbledhëse, kemi të bëjmë me një figurë shumëpërmasore, që i shpërtheu tabutë si në aspektin e historiografisë, po ashtu edhe për formatin intelektual.

Ta trajtohet figurën e Sh. Raçës hetohet se është e mbrujtur nga faktet, argumentet dhe arkiva të shumta, ngaqë ky autor i çmuar i historiografisë sonë është mbështetur në dokumenta-

cionin e pabotuar burimor, që ruhet në arkivat e Greqisë, Kosovës, AQSh, informata me shkrim dhe me gojë, shënime memoriale, kujtime, deklarata të pjesëmarrësve të ngjarjeve, shënime stenografike, literaturë e botuar historike shtypi i kohës etj. Pra, kemi të bëjmë me një profesionalitet të historianit bashkëkohor që ka arritur pikëpikëjen shkencore me atë historike, duke iu përbajtur kriterit profesional, dhe duke i dhënë lexuesit trajtesa e një vepra të rëndësishme historike, por edhe shfaqje të mjeshtërisë së shtjellimit të kontekstit të ngjarjeve të hapësirave greke dhe raporteve me shqiptarët.

Pak biografi për prof. dr. Shkëlzen Raçën

Prof. dr. Shkëlzen Raça, historian i mirënjohur, kur i duhej më së shumti Institutit Albanologjik dhe historiografisë shqiptare, u nda nga familja e dashur, nga shokët dhe nga fjala e tij e pathënë deri në fund në udhën e shkencës, sepse pas një sëmundje të rëndë, para katër vjetësh, më 25 shkurt 2014, pushoi së rrahuri zemra e tij e madhe. Derisa jetoi, prof. Shkëlzeni shquhej për mirësinë, ndershmërinë, korrektesën, mirësjelljen dhe fisnikërinë e tij. Ndaj edhe pse ishte i tillë, vdekja e tij na e mori para kohe. Vdekja e tij, jo vetëm familjarët, por edhe kolegët dhe miqtë e tij, i bëri që ta ndiejnë thellë humbjen e tij. Rrjedh nga një familje e emancipuar dhe e arsimuar e kohës. Shkëlzen Raça lindi në Skenderaj më 1 janar 1952. Në Prizren mori mësimet e para (deri në klasën e gjashtë, pjesën tjetër të fillores,

shkollën e mesme dhe fakultetin në Prishtinë. Me mbarimin e studimeve në Universitetin e Kosovës (Prishtinës), në Degën e Historisë, ai punoi si mësime-hënës i historisë në Gjimnazin "Sami Frashëri" në Prishtinë. Krahas punës edukativo-arsimore kreu edhe studimet post-diplomike në Fakultetin Filozofik të UP-së, ku më 1977 mbrojtë tezën e magistraturës, të titulluar "Lëvizja Kombëtare Shqiptare dhe Revolucioni Xhonturk", ndërsa më 1987 mbrojtë edhe temën e doktoraturës me punimin e tij "Marrëdhëniet shqiptaro-greke 1829-1881". Që nga viti 1977 ai punoi në Institutin Albanologjik në Prishtinë si bashkëpunëtor i lartë shkencor në Degën e Historisë. Krijimtaria e Shkëlzen Raçës është e gjerë, por pjesa më e madhe e kontributit shkencor është në marrëdhëniet e shqiptarëve me kombet e tjera, veçmas me grekët. Vepra e parë është "Marrëdhëniet shqiptaro-greke 1829-1881", e botuar më 1990. Kjo vepër u botua në 4 000 kopje, pra me një tirazh rekord. Vepra e dytë e botuar më 2004 është "Shtegtimet dhe ngulimet e shqiptarëve në Greqi shek. XIII-XVI", ku në mënyrë të dokumentuar dhe bindëse paraqiti shtrirjen e shqiptarëve në një hapësirë të madhe të Greqisë, ku godet tezën mashtruese sllave e greke për, kinse, ekspansionin e shqiptarëve në Ballkan. Vepra e tretë dhe e fundit është "Gjurmime në historinë shqiptare", përmbledhje e shumë kontributeve studimore, publicistike-historike, pikëpamjeve dhe vlerësimeve të tij. Një prej arritjeve më të mëdha të prof. Xenit ishte zbulimi i "Ëvetarit" të dytë të Naum Veqilharxhit të cilën Xeni me

modesti rrallëherë e përmendte. Më shumë për këtë zbulim të Xenit shkruante prof. dr. Myslim Islami, i cili thekson se "historiani i ri i Institutit Albanologjik, Shkëlzen Raça, përpos 'Allfavitarit shqip' (1872) të Konstadin Kristoforidhit dhe të 'Apologjisë' të Jani Vretos, do t'ma sjellë edhe 'Ëvetarin' të Naum Panajot Haxhi Lazër Bredhit. 'Ëvetari' 1845 i Naum Veqilharxhit ishte gjetur aty ku kam menduar dhe mendoj se gjenden librat e rrallë shqip, në Athinë", shkruante Myslim Islami.

Jeta e tij ishte e veçantë në thjeshtësinë e saj. Nëse ajo do të mund të shprehej grafikisht ishte veçse një vijë e drejtë. Por, më e veçanta ishte se ai la përshtypje e mbresa të thella dhe kujtime të pashlyeshme tek të gjithë ata që e njihnin. Dhe kjo ishte veçse ndikimi i asaj jete të thjeshtë, e një njeriu të thjeshtë, por vërtet madhështor në atë thjeshtësi, në formimin e tij tërësor. Shkëlzen Raça ishte i sinqertë dhe i dashur, ishte i ditur dhe i kulturuar si një studiues, ngulmues, miqësor, i drejtë dhe i ndershëm si ai. Përvoja në jetë e në punë ia kishin krijuar edhe tiparet modeste. Mbi të gjitha ai ishte i fortë në karakter dhe në vullnet. Rrallëkush mund t'i përngjasë një personazhi si miku im i paharruar.

Dr. Shkëlzen Raça, me opusin e tij shkencor, mbetet një nga historianët shqiptarë të brezit të mesëm më të arrirë. Ai pa asnjë mëdyshje bartë me vete meritën e madhe të ndriçimit të pjesës më komplekse të historisë sonë të periudhës së Rilindjes, atë të marrëdhënies tona me fqinjin jugor Greqinë. Vepra e tij do të mbetet një uverturë për

studimet e reja në këtë fushë. Ndërsa dr. Shkëlzen Raça me veprën e tij jetësore do të mbetet miku dhe kolegu i paharruar dhe shumë mbresëlënës për secilin që e njohu. Modestia, çiltërsia, erudicioni, por edhe këmbëngulësia e bëjnë atë personalitet shumë të kompletuar me të cilin mburret sot jo vetëm familja, por të gjithë ne miqtë dhe kolegët e tij. Me veprën e tij njerëzore dhe krijuese pa dyshim se ai e ka të rezervuar vendin në mesin e figurave më meritore të shtetit dhe kombit të tij.

Qoftë i përjetshëm kujtimi dhe respekti për veprën e tij!

Gjashtëdhjetë e dy vjet të jetës së tij janë të përshkuara me të veçantën e tij, thjeshtësinë. Nëse ajo do të mund të shprehej grafikisht ishte veçse një vijë e drejtë dhe një qëndrim vertikal. Por, më e veçanta e tij është përshtypja e mbresa e thellë dhe kujtimet e pashlyeshme që i la, tek të gjithë ata që e njihnin. Dhe ky ishte veçse ndikimi i asaj jete të thjeshtë, e një njeriu të thjeshtë, por vërtet madhështor në atë thjeshtësi, në formimin e tij tërësor. Shkëlzen Raça ishte i sinqertë dhe i dashur, ishte i ditur dhe i kulturuar si një studiues, ngulmues, miqësor, i drejtë dhe i ndershëm si ai. Përvoja në jetë e në punë i kishin krijuar edhe tiparet modeste. Mbi të gjitha, ai ishte i fortë në karakter dhe në vullnet. Rrallëkush mund t'i përngjasë një personazhi sa miku im i paharruar. Profesori Raça ishte i pajisur me njohuri universale e shkencore, por e veçanta e tij ishin marrëdhëniet greko-shqiptare. I tillë mbeti ai në kujtesën e kolegëve e të kujtdo që e njohu figurën e veprën e tij, porositë e së cilës zgjojnë tek brezat ndjenjën e frymëzimit.



E jashtëzakonshme

I gjithë fshati në dietë

Bashkia e Naronit në Spanjë, e cila ka 39 426 banorë, ka vendosur të dobësohet kolektivisht. Banorët e kësaj bashkie kanë ndërmarrë një nismë për ta përmirësuar shëndetin e tyre. Ata kanë vendosur të humbasin 100 mijë kilogramë për dy vjet. "Komuniteti është i fokusuar të bëhet i shëndetshëm dhe kemi vendosur si objektiv të humbasim 100 mijë kg", ka treguar doktori Carlos Pinero.



FOTO E DITES



Një person në Nepal pinë duhan gjatë ritualeve fetare në ambientet e tempullit Pashupatinath. /Reuters/

E rrallë

Heroi 88-vjeçar shpëtoi gruan nga pesë grabitës me thika

Pesë grabitës të rinj, të armatosur me thika, nuk e kanë trembur një 88-vjeçar i cili i doli në mbrojtje një gruaje e cila po sulmohej në rrugën "Raglan" në Londër. Ish-veterani i SAS, John Nixon, ndërhyri menjëherë duke u dhënë një "mësim të mirë" grabitësve, teksa po sulmonin gruan kalimtare. Nixon mori disa plagë të lehta, por e arriti synimin e tij duke u kthyer në një hero.



BARSOLETA E DITËS



- O plak, a more vesh që Goni është në spital?
- Çfarë thua?! Unë dje e pashë me një alamet femër.
- E kish parë edhe gruaja e vet.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:00

"FERDINAND"

3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 46 min

Rolet: John Cena, Kate McKinnon, Gina Rodriguez, Daveed Diggs, Gabriel Iglesias, Bobby Cannavale, David Tennant, Anthony Anderson, etj.

Regjia: Carlos Saldanha



Në ora 18:00 dhe 20:00 (R) "FIFTY SHADES FREED"

Dramë/Romansë/Triller; 1 orë 41 min

Rolet: Dakota Johnson, Jamie Dornan, Eric Johnson, Rita Ora, Luke Grimes, Victor Rasuk, Jennifer Ehle, Eloise Mumford, Max Martini, Callum Keith Rennie, Bruce Altman, Arielle Kebbel, Robinne Lee, Brant Daugherty, Marcia Gay Harden, etj.

Regjia: James Foley

Në ora 22:00 (PG-13)

"THE COMMUTER"

Krim/Dramë/Mister; 1 orë 44 min

Rolet: Liam Neeson, Vera Farmiga, Patrick Wilson, Jonathan Banks, Sam Neill, etj.

Regjia: Jaume Collet-Serra



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.



DASHI

Një e martë mjaft produktive dhe me plot angazhime interesante. Sot do të jeni në një vorbull ndjenjash të panjohura.



DEMI

Sot do ta tërhiqni vëmendjen e një kolegu të ri në kompaninë tuaj. Do të jeni me fat nëse dini se si të silleni në këtë situatë.



BINJAKËT

Nëse jeni munduar për të arritur në zgjidhjen përfundimtare të një problemi, sot do të kërkonit t'ju njihen meritat.



GAFORRJA

Sot po investoni në blerje për gjërat në shtëpinë tuaj. Doni të krijoni një ambient sa më komod për familjen.



LUANI

Një ngjarje në mbrëmje do t'ju ritakojë me një mik të vjetër. Kujdesuni që mos ta lodhni mikun me gjëra të pavlera.



VIJGJËRESHA

Sot keni mjaft dyshime dhe lëkundje rreth një mendimi për një person të caktuar. Do t'ia shprehni këtë gjë partnerit i cili do t'ju këshillojë.



PESHORJA

Kundërshtitë që keni në familje lidhur për një çështje të caktuar, gjatë ditës së sotme do të thellohen. Vendimi juaj bie ndesh me shumë persona.



AKREPI

Sot ëndëroni për dashurinë dhe keni marrë pamjen e një romantiku të thekur. Realizojini ëndrrat kur t'ju ofrohet mundësia.



SHIGJETARI

Jeni shumë të shoqërueshëm sot dhe do ta gjeni veten në ambiente të ndryshme që nuk kanë lidhje me rutinën tuaj të përditshme.



BRICJAPI

Kur zhyteni në punë harroni gjithçka tjetër. Sot duhet t'i përkushtoni pak më shumë kohë rrethit tuaj shoqëror që ju ndien mungesën.



UJORI

Sot paraqitet një ditë shumë e bukur për ju. Kur ka gjëra interesante në qytet, ju jeni të parët që do të shkoni vetëm ose me miqtë.



PESHQIT

Do të ndani me një mik një sekret që ju mundon. Mbase duke folur do të dini ta zgjidhni mënyrën më të mirë për ta përballuar.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

SEVILLA - MAN UTD

GG3+

SHAKHTAR DONETSK - ROMA

2

CSKA MOSCOW - CRVENA ZVEZDA

1

Mund ta befasojmë Poloninë

Përfaqësuesja e Kosovës në basketboll ka filluar përgatitjet për ndeshjet kualifikueset evropiane për Kupën e Botës, kurse dy basketbollistët Dardan Berisha dhe Erjon Kastrati shprehin optimizëm për ndeshjen e parë ndaj Polonisë, e cila zhvillohet më 23 shkurt

EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 20 SHKURT - Kapiteni i Kosovës në basketboll, Dardan Berisha, ka premtuar maksimumin në stërvitje në mënyrë që të befasojë Poloninë në ndeshjen që zhvillohet më 23 shkurt. Këto komente ylli i basketbollit shqiptar i bëri pas stërvitjes së parë të martën që Kosova e zhvilloi në Torun të Polonisë. "Përgatitjet i kemi filluar dhe jemi shumë të lumtur që jemi kthyer sërish bashkë. Ne i dimë qëllimet tona, por edhe e dimë se nuk do të jetë lehtë. Të gjithë bashkëlojtarët janë në gjendje të mirë shëndetësore dhe kjo na jep motivim që të bëjmë sa më mirë në duel me Poloninë. Ne do ta japim 100 % tonë në stërvitje dhe do të mundohemi të

bëjmë një befasi për të mposhtur një ekip të fortë siç është Polonia", ka thënë Berisha, i cili ka treguar që Scott Bamforth nuk ka pasur mundësi t'i bashkëngjitet përfaqësueses për shkak të rikuperimit. Berisha konfirmoi me këtë rast se Shawn Jones është pjesë e Kosovës për ndeshjet e radhës në kuadër të Dritares së Dytë të kualifikimeve evropiane për Kupën e Botës "Kina 2019".

Kosova më 23 shkurt do të luajë ndaj Polonisë nga ora 19:00 në Wloclawek, kurse më 26 shkurt në Klaipeda do të jetë mysafire e Lituanisë. Lidhur me ndeshjen e radhës ndaj Polonisë ka folur edhe Erjon Kastrati, i cili fillimisht ka shprehur gëzimin e madh që ka, pasi është rikthyer në përfaqësuese. Edhe Kastrati, ashtu si Berisha, beson në rezultat pozitiv.



"Jam i lumtur që jam rikthyer në përfaqësuese, për çka e falënderoi Federatën e Basketbollit të Kosovës që na ka dhënë mundësi të grum-

bullohem disa ditë më herët, në mënyrë që të përgatemi sa më mirë për takimin me Poloninë. Ata kanë një përfaqësuese të fortë, por

jemi optimistë se duke e dhënë maksimumin nga vetja mund të marrim rezultat pozitiv", ka deklaruar Kastrati.

Liga e Kampionëve: Sevilla - United, Shakhtar - Roma

SEVILLE, 20 SHKURT (ER) - Fitueset e vitit 2016 dhe vitit 2017 në Evropa Ligë, Sevilla dhe Manchester United, do të përballen sonte (e mërkurë) në kuadër të Ligës së Kampionëve. Manchester Unitedi në ndeshjen e fundit në kuadër të FA Cup ka shënuar fitore me rezultat 2-0 ndaj Huddersfieldit, kurse dy golat në atë ndeshje i ka realizuar Romelu Lukaku. Kjo skuadër në Ligën e Kampionëve është kualifikuar si fituese e Ligës së Evropës, kurse në fazën e grupeve doli e para duke e lënë pas Bazelin, CSKA Moskën dhe Benfikën. Francezi Anthony Martial këtë fazë e përfundoi me tre gola të shënuar. Në anën tjetër, Sevilla e Vincenzo Montellës përfundoi e dyta në Grupin E, pas Liverpoolit dhe



para Spartak Moskës dhe Mariborit. Sevilla luajti dy herë baras me Liverpoolin 2-2 dhe 3-3, kurse në La Liga aktualisht pozicionohet në vendin e pestë. Ndeshjen e fundit në ligë kjo

skuadër e fitoi ndaj Las Palmasit (1-2). Mbrojtësi Simon Kjaer është i lënduar për këtë ndeshje, kurse në dyshim janë edhe Nolito dhe Sebastian Corchia. Pritet të mungojnë edhe Joaquin Correa dhe Ever Benega. Ndërsa Alexis Sanchez do të jetë në dispozicion që ta bëjë debutimin në Ligën e Kampionëve për Unitedin. Kiliani në kohën kur ishte pjesë e Barcelonës i ka fituar pesë përballjet ndaj Sevilas. Mungesat e Unitedit për këtë ndeshje do të jenë Marcos Rojo, Phil Jones, Marouane Fellaini dhe Zlatan Ibrahimović, por të gatshëm do të jenë Marcus Rashford dhe Ander Herrera. Ndeshja tjetër që zhvillohet të mërkurën është ajo në mes të Shakhtar Donetskut dhe Romës.



Talenti i Lirisë ftohet nga Shqipëria

PRIZREN, 20 SHKURT - Talenti i skuadrës së Lirisë, Diellor Beseni, ka marrë ftesë nga kombëtarja e Shqipërisë U-17. Lajmin e ka konfirmuar skuadra nga Prizreni nëpërmjet në faqen e vet zyrtare. "Beseni nga data 25 shkurt e deri më 4 mars

do të jetë i grumbulluar në skuadrën Tropikal të Durrësit, me U-17 që drejtohen nga Mustedanagiq. Ai ka një kohë që luan me juniorët e Lirisë me leje të veçantë, kurse nga e marta ka nisur të stërvitet me ekipin e parë", thuhet në njoftimin e Lirisë.

Maliqi dhe Lushtaku, në disiplinore

PRISHTINË, 20 SHKURT - Komisioni i Garave i Federatës së Futbollit të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur të martën, lidhur me regjistrimin e ndeshjeve të Vala Superligës për Kampionatin 2017/2018,

ka bërë inicim të procedurës disiplinore për kapitenin e KF Feronikeli, Behar Maliqi dhe drejtorin sportiv të KF Drenica, Tahir Lushtaku. Inicimi ndaj Maliqit është bërë me arsyen e ndërhyrjes së palejuar në loj-

tarin kundërshtar brenda zonës së repretësisë, në ndeshjen Drita - Feronikeli. Ky futbollist në atë ndeshje ishte ndëshkuar me karton të kuq. Ndërsa inicimi ndaj drejtorit të Drenicës, Tahir Lushtaku, vjen

si pasojë e asaj se Lushtaku pas përfundimit të ndeshjes ka hyrë brenda vijave kufizuese në fushë, duke shkuar në drejtim të gjyqtarit kryesor të ndeshjes, me ç'rast e ka sharë dhe ofenduar.



Wilderi kërkon përballje me Joshuan

WASHINGTON, 20 SHKURT - Boksieri amerikan Deontay Wilder ka konfirmuar dëshirën dhe objektivin e tij për një duel të madh në sportin e boksit, duke zgjedhur si rival për këtë përballje, kampionin amerikan të peshave të rënda, Anthony Joshua. Një përballje titanësh, që me shumë gjasa mund të ndodhë në vjeshtën e këtij viti, teksa në mars të dy

boksierët do t'i mbrojnë titujt kampionë bote. Wilderi do ta mbrojë titullin më 3 mars ndaj kubanezit Luis Ortiz, ndërsa Joshua më 31 mars do të duelojë ndaj neo-zelandezit Joseph Parker, një përballje që do ta sjellë unifikimin e titujve kampionë. "Dueli i madh i peshave të rënda që unë synoj është mes meje dhe Joshuas. Kjo është ajo që unë dua. Kam

dy vjet që e ftoj në një duel. Shumë njerëz shprehen se ai tani ka nisur të jetë profesionist, por unë jo, kam vite", ka thënë Wilderi.

Shifrat e boksierëve Wilder dhe Ortiz

"U them njerëzve që t'i shohin gjërat në detaje dhe të më mbështesin në këtë nismë, që

është në të mirë të boksit. Unë dua që të unifikohen titujt. Mua s'më interesojnë gjërat e tjera, thjesht të ketë një kampion të vetëm", tha më tej Wilderi, kampion bote në peshat e rënda në kategorinë WBC. Ai



do të duelojë në Nju Jork ndaj Ortizit më 3 mars, ndërsa sfida mes Parkerit dhe Joshuas do të zhvillohet në Kardif.

Majlinda dhe ekipi i xhudos vizituan Festivalin Olimpik

PRISHTINË, 20 SHKURT - Kampionia olimpikë, Majlinda Kelmendi, xhudisti Akil Gjakova, trajneri Driton Kuka dhe kryetari i Federatës së Xhudos së Kosovës (FXHK), Agron Kuka, e kanë vizituar të martën Festivalin Olimpik PyeongChang 2018, i cili po mbahet në Sheshin "Zahir Pajaziti" në Prishtinë. Ata patën rastin ta praktikojnë edhe sportin e kërlingut, i cili, bashkë me patinazhin dhe hokejin, po promovohet nga Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK). Prania e ekipit të xhudos zgjoi kureshtjen e të pranishmëve, të cilët patën rastin ta shohin medalistën e artë në LO RIO 2016, Majlinda Kelmendi, duke shfaqur aftësitë e saj edhe në kërling. Akil Gjakova me vete kishte edhe medaljen e artë të fituar javën e kaluar në Grand Slamin e Parisit. Më pas, kampionët iu drejtuan edhe fushës me akull sintetik, ku dhjetëra fëmijë dhe vullnetarë patën rastin të fotografohen me ta. Në 12 ditët e



deritashme prej se ka filluar Festivali, sportet e kërlingut dhe patinazhit i kanë praktikuar dhjetëra mijëra fëmijë, kurse në dy ditët e fundit (24 dhe 25 shkurt) fëmijët do ta shijojnë edhe sportin e hokejit. Kujtojmë që me organizimin e këtij Festivali Olimpik, KOK-u është bërë Komiteti i nëntë Olimpik në

botë që organizon një festival të tillë madhështor, pas shteteve të fuqishme si: Italia, Franca, Belgjika, Holanda, Sllovenia, Republika e Çekisë etj. Festivali po mbahet krahas Lojërave Olimpikë Dimërore PyeongChang2018, të cilat po përcillen në ekranin gjigant të vendosur skaj aktivitetëve.

Norvegjia vazhdon t'i mbledhë medaljet në Lojërat Olimpikë Dimërore

PYEONGCHANG, 20 SHKURT - Norvegjia rrit numrin e medaljeve të arta në Lojërat Olimpikë Dimërore të Pyeongchangut në Korenë e Jugut. Në ditën e 10 të këtij eventi, nordikët triumfuan në disiplinën e kërcimit nga trampolinë në ski për skuadra dhe në garën e 500 m të patinazhit të shpejtësisë për meshkuj. Në kërcimin ekipor nga trampolina, Norvegjia në përfundim të dy raundeve grumbulloi 1098.5 pikë, duke marrë medaljen e artë. Në vendin e dytë u rendit Gjermania me 1075.7 pikë, ndërsa medaljen e bronzit e fitoi Polonia me 1072.4 pikë. Ndërsa në garën e 500 m të patinazhit të shpejtësisë për meshkuj, ai që i dha medaljen e artë të radhës Norvegjisë ishte Hvard Lorentzen me 34.41 sekonda, kohë kjo që përbën edhe rekord olimpik. Në vendin e



dytë me medaljen e argjendtë u rendit koreano-jugori Cha Min Kyu, ndërsa medalja e bronzit shkoi për kinezin Gao Tingyu. Në garën me slitë dyshe për meshkuj medalja e artë i shkoi Kanadasë me kohën 3 minuta 16 sekonda e 86 të qindtat. Në vendin e dytë u rendit Gjermania, ndërsa vendi i tretë me medalje të bronzit i

shkoi skuadrës së Letonisë. Në tabelën e medaljeve, Norvegjia vazhdon të kryesojë me 11 medalje të arta, 9 të argjendta dhe 8 të bronzta. E dyta është Gjermania me 10 medalje ari, 6 argjendi dhe 4 bronz, ndërsa në vendin e tretë është ngjitur Kanadaja me 8 medalje të arta, 5 të argjendta dhe 6 të bronzta.

SHKURT

Zidane: Do të luftoj të mbetem në Real

Trajneri i Real Madridit, Zinedine Zidane ka thënë se, pavarësisht prej ndryshimeve që mund të ndodhin në të ardhmen, ai do të vazhdojë të luftojë për ta ndihmuar ekipin e vet. "Unë jam mirë këtu. Do të vazhdoj të luftoj dhe do ta bëj këtë çdo ditë. Kjo është ajo që më ndihmon të jem më i fortë", ka thënë Zidane, i cili ka shtuar se, pavarësisht prej kontratës, do të përpiqet ta nxjerrë nga kriza Realin pas eliminimit nga Kupa e Mbretit dhe mbetjes jashtë garës për titull kampioni në La Liga, pasi Barcelona ka 17 pikë më shumë pas 25 javëve të para. "Do të luftoj për të qëndruar përgjithmonë këtu. Nëse do të vazhdoj të jem këtu, do t'jua them para përfundimit të sezonit. Pak para", ka shtuar francezi.

Mourinho e kërkon me çdo kusht Kroosin në "Old Trafford"

Toni Kroos është objektivi kryesor i portugezit Jose Mourinho për afatin kalimtar të verës. Në mesin e zërave spekulativë për largimin e Paul Pogbas shfaqet një tjetër emër për mesfushën e 'Djajve të Kuq', i cili pritet ta rrisë kualitetin në mesfushë. Por, ardhja e Kroosit nuk lidhet aspak me Pogban, pasi në mendjen e tij Mourinho ka ravigjzuar një treshe fantastike me gjermanin në krah të Matiqit e Pogbas. Kroosi, që në verën e vitit 2014 ishte shumë afër Manchester Unitedit, pasi la Mynihun, ka shprehur dëshirën për ta provuar një përvojë të re. 28-vjeçari është lojtari kyç i taktikës së Real Madridit dhe vlera e tij konsiderohet rreth 100 milionë euro. Në verën e vitit 2014 Bayern Muncheni ia ofroi Realit mesfushorin për 30 milionë euro dhe me të njëjtën vlerë bleu Xabi Alonso.

Casillasi dëshiron transferimin në Itali


Ikona e Real Madridit, Iker Casillas, dëshiron që në sezonin e ardhshëm të luajë në kampionatin italian. Ish-portieri legjendar i Realit, Casillasi, do të largohet nga Porto në fund të këtij sezoni, kur edhe i skadon kontrata. Ai ka kërkuar nga agjenti i tij që t'i gjejë një skuadër në Itali. 36-vjeçari kishte disa oferta nga skuadrat amerikane, por preferon një karrierë të re në Itali, ku tashmë thuhet se janë disa skuadra të interesuara për t'i siguruar shërbimet e tij.

Moura: Tottenhami mund ta fitojë Ligën e Kampionëve

Tottenhami ishte ndalur nga skuadra e kategorisë së tretë, Rochdale, të dielën, por entuziazmi i transferimit të ri, Lucas Moura, nuk ka ndryshuar. Ai ka shprehur mendimin se Tottenhami është në gjendje ta sfidojë për titullin e Ligës së Kampionëve. Anëtori e la PSG-në për Tottenhamin në janar pasi transferimet e Neymarit dhe Mbappes ia kufizuan minutazhin. "Secili lojtar dëshiron të fitojë trofe, ta bëjë historinë dhe unë jam këtu për ta bërë historinë me shokët e mi të rinj, bashkëlojtarët e mi të rinj. Unë besoj se për shkak se kemi shumë cilësi dhe strukturë të mirë, jam vërtet i impresionuar. Në mund të ëndërojmë për Ligën e Kampionëve", ka deklaruar Moura.


Zbulohet motori i ri i Hondas

Në Xhakarta të Indonezisë u zbulua motori i ri Honda RC213V, me të cilin Marc Marquez dhe Dani Pedrosa do të kërkojnë ta mbrojnë titullin që fituan vitin e kaluar. "Është kënaqësi e madhe të jem sërish në Indonezi për ta reklamuar motorin e ri. Xhakarta është shumë familjare për ne falë mbështetjes që na japin fansat tanë. Deri tani kemi kryer vetëm dy teste dimërore, që kanë shkuar përgjithësisht mirë. Do të punojmë fort që në testet e Katarit më 1 deri 3 mars t'i marrim të gjitha informacionet e nevojshme për të qenë gati për sezonin e ri. Duam të luftojmë për fitore edhe në këtë sezon dhe të dhurojmë spektakël për të gjithë të apasionuarit e Moto GP", ka pohuar Marquez.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Drejtoria e Arsimit
N°/11-202 /2018
Klinë, 16/02/2018

Në bazë të nenit 11, paragrafi 1 i Ligjit mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr.03/L-149 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.72/2010),nenit 34, paragrafi 5 i Ligjit për Arsimin Parauniversitar nr.04/L-032, nenit 5, pika C e Ligjit për Arsim në Komunitet të Republikës së Kosovës nr.03/L-068, nenit 2, pika 2 e UA nr.08/2014 për procedurat dhe kriteret e zgjedhjes së drejtorit të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësues, Drejtori i Drejtorisë për Arsim shpall:

KONKURS PUBLIK PËR
Drejtor të institucioneve edukativo-arsimore si në vijim:

- SHFMU " Motrat Qiriazit" Klinë, numër reference: JP00032230
- SHFMU " At Gjergj Fishta" Jagodë, numër reference: JP00032237
- SHFMU " Dëshmorët e Kombit" Qabiq, numër reference: JP00032334

Koeficienti i pagës: 7.8

Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit të shkollës:

- Menaxhimi dhe administrimi i përgjithshëm i institucionit shkollor,
- Hartimin e planeve vjetore të punës dhe planin zhvillimor të shkollës,
- Koordinimi i punës me Këshillin e shkollës,aktivet profesionale dhe organet tjera qeverisore në shkollë,
- Detyrat dhe obligimet që dalin në bazë të plan programit mësimor aktual,
- Ruajtja e dokumenteve dhe të dhënave ashtu si parashihet në Ligjin e arsimit dhe në aktet normative,
- Monitorimin e orëve mësimore,
- Vlerësimin e performancës së mësimdhënësve dhe stafit tjetër administrativ dhe teknik,
- Planifikimin e buxhetit të shkollës dhe menaxhimi sipas kërkesave;
- Ruajtjen e dokumentacionit financiar dhe llogaridhënia për shpenzimet buxhetore,
- Pjesëmarrjen në panelin për pranimin e kuadrit në shkollë,
- Nxjerrjen e vendimeve për themelimin e komisioneve të ndryshme në interes të shkollës,
- Kryen detyra të tjera të ngarkuara nga ana e DKA-së dhe obligimet e përcaktuara me akte të tjera normative.

Për të gjitha pozitat:

Mbikëqyrësi: Drejtori i Drejtorisë së Arsimit
Orari i punës: 40 orë
Kohëzgjatja e Emërimit: Emërimi është me mandat 4 vjeçar.

Shkollimi i kërkuar për pozitat e kërkuara:

- Të kenë të kryer së paku arsimin universitar të nivelit themelor 4 vjeçar, 240 ECTS.
- Të kenë diplomë Universitare nga profilet arsimore të pranueshme për pozitën e mësimdhënësit sipas Udhëzimit për licencimin e mësimdhënësve dhe sipas normativit për Kuadrin mësimor dhe rregullativës tjetër ligjore.
- Të ketë licencë të rregullt për mësimdhënie ose të jenë në përfundim të procedurës së licencimit.

Përvoja, aftësitë dhe cilësitë e tjera:

- Së paku tri (3) vite përvojë pune në arsim.
- Të kenë të përfunduar me sukses një nga programet e akredituara të kualifikimeve profesionale për udhëheqje , administrim ose menaxhim të institucioneve edukativo – arsimore.

- Njohuri lidhur me ligjet, rregulloret e aplikueshme në fushën e arsimit dhe njohuritë lidhur me dokumentacionin shkollor dhe pedagogjik të nxënësve.
- Shkathësi në komunikim, planifikim dhe koordinim të punës së personelit në nivel të shkollës.
- Shkathësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve e këshillave profesionale.
- Shkathësi në komunikimin elektronik,kompjuterik në aplikacione të programeve (Word, Excel, Pwer Point, Access etj).


Dokumentet e nevojshme:

- Dokumentet personale (certifikata e lindjes dhe kopja e letërnjoftimit);
- Diploma e kualifikimit e noterizuar;
- Certifikatat e trajnimeve të akredituara nga MASHT,
- Dëshmia e licencës së mësimdhënësit (vendimi dhe licenca), ose dëshmia që është në procedurë të licencimit,
- Dëshmia e përvojës së punës në arsim,
- Portfolio profesionale (sipas udhëzimeve në shtojcën G të UA nr 08\2014)
- Letër-referencë nga një institucion publik kredibil si MASHT-i, DKA-ja,Këshilli drejtues i shkollës, punëdhënësi paraprak ose nga institucionet e arsimit të lartë. Letrat e referencës duhet të kenë përmbajtje dëshmuese për punën dhe angazhimin paraprak.
- Plani zhvillimor i institucionit edukativ arsimor dhe aftësues për të cilin konkurron (së paku 10 faqe tekst me hapësirë 1.5 dhe me font të shkronjave Arial, madhësia 11, sipas udhëzimeve të MASHT-it,
- Certifikata shëndetësore e lëshuar nga një institucion publik shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja shëndetësore e kandidatit,
- Dëshmia se kandidati nuk është nën hetime.


Mënyra e Aplikimit:
Formularët për aplikim merren në Drejtorinë e Arsimit dhe dorëzohen po në të njëjtën drejtori. Për informata me të hollësishme mund të kontaktoni në Drejtorinë e Arsimit direkt ose përmes telefonit fiks 03820043727.

Konkursi mбетet e hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik. Dokumentet e pakompletuara dhe pas afatit nuk pranohen.

Ligji i Shërbimit Civil ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëprept aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore si dhe nga të gjitha komunitetet në Kosovë.




Drejtori i DKA-së
Arben Limana



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Drejtoria e Arsimit
N°/11-202 /2018
Klinë, 16/02/2018

Na dsnovi clana 11, stav 1 Zakona Civilne Sluzbe Kosova broj 03/L-149 (Sluzbeni List Republike Kosova 72/2010), clana 34, stav 5 Zakona o Predunivesitetskoj Obrazovanja 04/L-032, clana 5, tacka C Zakona Obrazovanja u Opstinama Republike Kosova 03/L-068, clana 2, tacka 2 AU br.08/2014 o postupcima i uslovima izabranja direktora edukativnih-obrazovnih institucija, Direktor Odeljenja Obrazovanja objavlja:

JAVNI KONKURS
za
Direktore edukativno-obrazovnih institucija kao sledece:

- NOŠŠ " Motrat Qiriazit" Klina, broj ref: JP00032230
- NOŠŠ " At Gjergj Fishta" Jagoda, broj ref: JP00032237
- NOŠŠ " Dshmorwt e Kombit" Qabiq, broj ref: JP00032334

Koeficienat plate: 7.8

Duznosti i odgovornosti:

- Rukovodjenje i administriranje škole,
- Priprema godisnjih planova rada i razvojnog plana škole,
- Sradjivanje sa savetom škole, profesionalim aktivimam i ostalim telima skola.
- Sacuvanje raznih dokumenata i podataka predvidjeno zakonom i ostalim normativnim dokumentima,
- Nadgeladavanje obrazovnih casova,
- Ocenivanja performanse nastavnika i ostalih radnika škole,;
- Planiranje i upravljanje budzetom škole;
- Sacuvanje finansiskoh dokumenata i davaje odgovornosti o troskovima,
- Ucesce u panelu za prijem skolskog kadra,
- Uzimanje odluka za osnivanje raznih komisija za interes škole,
- Ostale zadatke date od OOO u skladu sa vazecom normativom.

Broj referencije direktora NOŠŠ-ve: JP00029398

Za sve pozicije:

Nadzornik: Direktor Odeljenja za Obrazovanje
Radno Vreme: 40 sati
Rok Imenovanja: 4 godisnji mandat

Obavezno skolovanje:

- Minimum 4 godisnji universitetski nivo i uz 240 ECTS.
- Univezitetska diploma za nastavnike na osnovi upustva o licensiranju obrazovnog kadra.
- Regulama licenca za obrazovanje ili pri kraju licensiranja.

Iskustvo, sposobnosti i ostalo:


- Najmanje 3 godine iskustva u obrazovanju.
- Najmanje jedno od akreditiranih profesionalnih programa za upravljanje, administriranje ili rukovodjenje obrazovnih institucijama.
- Znanje o zakonima i regulativom oko obrazovanja kao i o skolskom i pedagogskom dokumentaciji ucenika.
- Znanje o komuniciranji, planiranju i koordiniranu rada kadra škole.

Trazeni dokumenti:

- Licni dokumenti (izvod rođenja i kopija licne karte);
- Noterizovana diploma skolovanja;
- Dokaze o obukama akreditirane os MONT,

- Dokaz licensiranja kao nastavnik ili dokaz da licensiranje je u toku,
- Đokaz iskustva,
- Profesionali portfolio (na osnovi upustva aneksa G AU br 08\2014)
- Referentno nismo od krediblen javne institucije ud dokaz o prethodnom iskustvi i sposobnostima.
- Razvoji plan skolske institucije za koju konkurise (najmanje 10 stranice, razmak redova 1.5, slova Arial, velicina 11, po upustvima MONT),

Način konkurisanja:
Formulari za prijavu mogu se dobiti u Opštinskoj odeljenji obrazovanja i predaju se takodje u istoj odeljenji. Za detaljnije informacije možete kontaktirati odeljenje obrazovanja direktno ili preko telefona 03820043727. Rok konkurisanja je 15 dana od dana objavljivanja u sredstvima javnog informisanja. Nepotpuni dokumenti kao i oni predati posle roka neće se prihvatiti. Predati dokumenti se ne vraćaju. Civilna Sluzba Kosova pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Republika Kosova i pozdravlja aplikacije muškog i ženskog pola kao i svih zajednica na Kosovu.



Direktor Odeljenja Obrazovanja
Arben Limana

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

Banka Ekonomike

NJOFTIM PËR SHITJE PËRMES ANKANDIT TË PARË PUBLIK

Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan-në përbërje të gjyqtarit përbarues Avdirrahman Gashi ka nxjerrë Konkluzion E.nr.967/2012,të datës 04.01.2018,për shitjen e pasurisë së paluajtshme të hipotekuar të debitorit NTP"Shpeta",me seli në Prishtinë.

Kjo pasuri e paluajtshme është evidentuar në emër të garantuesit hipotekar Xhemajl Bikliqi nga fshati Janjevë,Komuna Lipjan,pjesa e pronës në 1/1 e pasurisë,e cila evidentohet në fletën e posedimit-çertifikatën mbi të drejtat e pronës:

Fleta poseduese P-71409026-00738-ngastra kadastrale P-1040-0,në sipërfaqe të përgjithshme prej 3495m²,lloji i pronës parcelë,me kulturë bujqesore ,kjo pasuri gjindet në vendin e quajtur "Bara do Puta ",Zona Kadastrale Gushtericë e Ulët,Komuna Lipjan.

Kjo pasuri do të shitet në Ankand Publik, në mbështetje të dispozitës së nenit 234 të Ligjit për Procedurën Përbarimore,me qëllim të sigurimit të mjeteve për të përbushur obligimet e debitorit NTP "Shpeta"me seli në Prishtinë,ndaj kreditorit Banka Ekonomike sh.a.Prishtinë.

Pasuria e paluajtshme e hipotekuar është e vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 122,325.00 Euro.

Në seancën lidhur me ankandin e parë publik, palujtshmëria nuk mund të shitet për çmimin që është më i vogël se 50%e vlerës së përcaktuar.

Data e mbajtjes së ankandit publik-shitjes së pasurisë:me 22.02.2018.

Koha e shitjes: 10:00

Vendi i shitjes: Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan.

Të interesuarit duhet të deponojnë shumën prej 1/10 e vlerës së cekur të pasurisë së paluajtshme, por jo më shumë se 5,000.00 Euro në emër të kaucionit në depozitën e gjykatës,me të drejtë të kthimit të kaucionit-ofertuesve të pasuksesshëm.

www.bekonomike.com

Banka Ekonomike Sh.A
Sheshi Nënë Terezë p.n
10000 Prishtinë, Kosovë

info@bekonomike.com
Tel. +381 (0) 38 500 500
Fax. +381 (0) 38 500 507

Shijo Pranverën me...

Jaffa Champion PLUS A+C+E Multifrutti

Taste of World Wide Brand!

2L

Jaffa Champion

*Gjithmon me marr malli për voin tëm
Urimë dita e pavaresisë!*

RC
cola

*Urimë perjetori i 10 Kosovë
Shpresoj që 10 vjetoria e ardhshme
familjet e mi kanë me qare krenar
me kësi ba në sot.*


*Njësojta ka shumë punë që me arrit a
ka duhet por e di që këtu ka njëz që
shumë dhe kanë besim në ardhmerinë e*

**10 mesazhe
Kosovës**

*Sot 10 vjet kjo ditë ka qare anderr për n
Qe prej asaj dite une besoj që puna m
gjithmonë kthehet! Urimë Kosova jonë!
Zemra pushon në këtë!*

**MADE IN
KOSOVA**

*Shpresoj ma t'mirën për Kosovën
e që vitet e ardhshme t'jone ma tsuksesshm
Gëzuar perjetori i pavaresisë!*



Revistën për kulturë, gjuhë, media, "Akademia", mund ta gjeni në redaksinë e gazetës "Epoka e re", në Sheshin "Edit Durham", 100 metra larg "Grand Hotel"-it. Për informata të tjera mund të thërrisni në këtë numër të telefonit: +377 44 127 434.